Elton Harxhi

EDUKATA ISLAME

(Për fëmijë nga 8-11 vjeç)

Pjesa 1

EDUKATA ISLAME

(Për fëmijë nga 8-11 vjeç)

Autor: Elton Harxhi

Redaktor fetar: Eduart Thartori

Redaktor gjuhësor: Eglantin Kurti

Korrektoi: Amine Harxhi

Përkujdesja grafike: Erzen Pashaj

Pikturat: Anisa Shkullaku

Kuriozitetet: Oriada Toli

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga autori.

Botimi i parë, Tiranë 2021

Përmbajtja

Mësimi 1	EDUKATA ME ALLAHUN	3
Mësimi 2	EDUKATA ME FENË	13
Mësimi 3	EDUKATA ME PROFETIN (A.S.)	23
Mësimi 4	EDUKATA ME KURANIN	33
Mësimi 5	EDUKATA E DHIKRIT (PËRMENDJES SË ALLAHUT)	43
Mësimi 6	EDUKATA E LUTJES	53
Mësimi 7	EDUKATA E PASTËRTISË	63
Mësimi 8	EDUKATA E EZANIT	75
Mësimi 9	EDUKATA E NAMAZIT	85
Mësimi 10	EDUKATA NË XHAMI	95
Mësimi 11	EDUKATA E AGJËRIMIT	105
Mësimi 12	EDUKATA E DIJES	117
Mësimi 13	EDUKATA KUNDRA SHEJTANIT	127
Mësimi 14	EDUKATA ME PRINDËRIT	139
Mësimi 15	EDUKATA ME KOHËN	147
Mësimi 16	EDUKATA E GJUHËS DHE KOMUNIKIMIT	157
Mësimi 17	EDUKATA E USHQIMIT	169
Mësimi 18	EDUKATA E GJUMIT	179
Mësimi 19	EDUKATA E SHËNDETIT	193
Mësimi 20	EDUKATA GJATË FESTAVE	207
Mësimi 21	EDUKATA E VESHMBATHJES	221
Mësimi 22	EDUKATA BRENDA DHE JASHTË SHTËPISË	231
Mësimi 23	EDUKATA ME SHOKËT DHE VËLLEZËRIT MUSLIMANË	241
Mësimi 24	EDUKATA ME MJEDISIN DHE GJALLESAT	251
Mësimi 25	EDUKATA NDAJ FENOMENEVE NATYRORE	263
Mësimi 26	EDUKATA E SADAKASË	275
Mësimi 27	EDUKATA ME TË VARFËRIT DHE JETIMËT	285
Mësimi 28	EDUKATA E UDHËTIMIT	293
Mësimi 29	EDUKATA ME KOMSHIUN	303
Mësimi 30	EDUKATA ME FAREFISIN DHE TË AFËRMIT	311

Parathënie

Të gjitha lavdërimet dhe falënderimet i takojnë Allahut të Madhëruar. Vetëm Atë e falënderojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë kërkojmë. Dëshmojmë me gjithë zemër, se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe dëshmojmë gjithashtu, se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Allahut.

Të dashur fëmijë!

Edukimi luan një rol të rëndësishëm në jetën tonë të përditshme, bazuar në rregullat dhe parimet e Islamit. Njeriu në këtë botë duhet të ndërtojë raporte dhe marrëdhënie me Zotin, me Profetin (a.s), me Kuranin, me njerëzit, me natyrën, me gjallesat dhe me gjithçka që e rrethon. Këto marrëdhënie duhet të jenë të drejta, me qëllim që jeta të vazhdojë normalisht. Të gjitha këto marrëdhënie dhe raporte i kemi mësuar pa dyshim nga Kurani dhe nga fjalët e Profetit Muhamed (alejhi selam).

Pikërisht ky libër, pra "Edukata Islame", na mëson etikat dhe rregullat, se si të ndërtojmë raporte dhe marrëdhënie me gjithçka që na rrethon, në përputhje me mësimet e fesë islame.

Çdo fjali, informacion, tregim, dialog dhe gjithçka që gjendet në këtë libër përcjell një mësim dhe mesazh të fuqishëm. Prandaj mundohuni të përfitoni sa më shumë prej këtij libri.

Shpresoj që të përfitoni sa më shumë nga ky libër me vlera.

Mësimi 1

EDUKATA ME ALLAHUN

Edukata me Allahun

- Allahu ka krijuar qiellin
- Allahu ka krijuar tokën
- Allahu ka krijuar malet
- Allahu ka krijuar kafshët

Allahu është Krijuesi

Trego disa krijesa, që i ka krijuar Allahu:

1 .....

2.....

3.....

4.....

5.....

6.....

7.....

Profeti Ibrahim (a.s) ka thënë:

Allahu më ka krijuar dhe më udhëzon.
Allahu më ushqen dhe më jep të pi.
Allahu më shëron, kur sëmurem.
Allahu do të më ringjallë, pasi të vdes.
Allahu do të m'i falë gabimet e mia".



Allahu na ka dhuruar shiun
Allahu na ka dhuruar prindërit

Allahu është Dhuruesi

Trego disa nga mirësitë, që na ka dhuruar Allahu:

Allahu na ka dhuruar.....
Allahu na ka dhuruar.....
Allahu na ka dhuruar.....
Allahu na ka dhuruar.....
Allahu na ka dhuruar.....
Allahu na ka dhuruar.....
Allahu na ka dhuruar.....

Mirësi të tjera të Allahut:

- Feja islame.
- Zbritja e Kuranit.
- Dërgimi i Profetit Muhamed (a.s).

Profeti Sulejman (a.s) dhe mirësitë e Allahut:

- Profeti Sulejman (a.s) ka qenë mbreti më i madh i kohës së tij.
- Profeti Sulejman (a.s) kishte një ushtri, që përbëhej nga njerëzit, xhindet dhe shpendët.
- Profeti Sulejman (a.s) kishte kuaj shumë të bukur.
- Profeti Sulejman (a.s) dinte gjuhën e kafshëve dhe të shpendëve.
- Profeti Sulejman (a.s) komandonte erën (me lejen e Allahut), e cila e çonte ku të dëshironte
- Profeti Sulejman (a.s) e falenderonte gjithmonë Allahun për mirësitë e panumërta, që Ai i kishte dhuruar.

La ilahe il-lall-llah

Nuk ka zot tjetër përveç Allahut

- Stop adhurimit të idhujve
- Stop adhurimit të teqeve
- Stop adhurimit të njerëzve

Vërtetësia e idhujve



- Idhujt nuk kanë krijuar asgjë.
- Idhujt nuk na kanë dhënë asgjë.
- Idhujt nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë.
- Idhujt nuk i përgjigjen lutjes së askujt.

Allahu thotë në Kuran:

"Thuaj: Allahu është Një, i Vetëm.
Allahu është Ai, që çdo krijesë ka nevojë për Të.
Ai nuk lind (kënd), as nuk është i lindur (prej dikujt).
Dhe askush nuk është i barabartë me Të".

Nuk ka zot tjetër përveç Allahut

Besimi i Profetëve:

- Profeti Adem (a.s) besonte dhe adhuronte vetëm Allahun.
- Profeti Nuh (a.s) besonte dhe adhuronte vetëm Allahun.
- Profeti Ibrahim (a.s) besonte dhe adhuronte vetëm Allahun.
- Profeti Jusuf (a.s) besonte dhe adhuronte vetëm Allahun.
- Profeti Musa (a.s) besonte dhe adhuronte vetëm Allahun.
- Profeti Daud (a.s) besonte dhe adhuronte vetëm Allahun.
- Profeti Isa (a.s) besonte dhe adhuronte vetëm Allahun.
- Profeti Muhamed (a.s) besonte dhe adhuronte vetëm Allahun.

Pra të gjithë profetët - nga i pari tek i fundit - besuan Allahun dhe adhuruan vetëm Atë !

Besimtari adhuron vetëm Allahun

- Albani po i lutet Allahut
- Selma është duke falur namazin
- Muslimani e madhëron Allahun
- Subhanallah
- Elhamdulilah
- Allahu Ekber

Edukata ime me Allahun:

Unë e besoj Allahun.

Unë e falenderoj Allahun për të mirat
që më ka dhënë.

Unë i mbështetem Allahut.

Unë e madhëroj Allahun.

Unë i bindem Allahut.

Unë adhuroj vetëm Allahun.

Unë i lutem dhe i kërkoj ndihmë vetëm Allahut.

Unë jam i kënaqur me caktimin e Allahut.

Unë kërkoj falje tek Allahu.

ARGËTIM DHE ZBAVITJE

A e dini se:

Kush e shpiku orën? Atë e shpiku muslimani i devotshëm Al Xhezari. Ai ishte nga Turqia dhe u bë inxhinieri i parë, që prodhoi makinën automatike.

Kuiz:

Çfarë ngjyre ka kali i bardhë i Skënderbeut?

Përgjigja: Të bardhë.

Gjëegjëzë:

Është e ëmbël
Rrumbullak
Kur e prek
Të bën me gjak

(manaferra)

Për të qeshur:

Mamaja: Genti, nuk të vjen turp që e lëpin tortën?
Genti: Mama, gjuha ime është e pastër....

Labirinth:

Gjej rrugën për tek Qabja.



USHTRIME

Ushtrimi 1: Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!

1- Kush i ka krijuar tokën, qiellin dhe gjithçka që na rrethon?
2- Çfarë mirësish i kishte dhënë Allahu Profetit Sulejman (a.s)?
3- A duhet të adhurohen idhujt?
4- Kë besonin dhe adhuronin Profetët e Allahut (Paqja qoftë mbi ta)?
5- Thuaj disa fjalë, që shprehin madhërimin e Allahut.

Ushtrimi 2: Plotëso vendet bosh!

1- Nuk ka ..... tjetër përveç .....
2- Stop adhurimit të .....
3- Allahu është ..... dhe .....
4- Profeti Sulejman (a.s) e ..... Allahun për mirësitë që i kishte dhënë.
5- Idhujt nuk kanë krijuar .....
6- Albani po i ..... Allahut.

Ushtrimi 3: Si kanë vepruar këta fëmijë?

Vendos shenjën ✓ ose ✗ për çdo rast.

☐ Abi e falenderon Allahun për mirësitë që i ka dhënë.
☐ Asimi shkon në teqe.
☐ Sara i lutet nënës natyrë, që ta ndihmojë në provim.
☐ Tedi e madhëron Allahun me tekbir.
☐ Seidi mendon, se e ka krijuar natyra.
☐ Esma adhuron vetëm Allahun.

Ushtrimi 4: Mëso përmendësh!

1- La ilahe il Allah. (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut).
2- Fjalët e Ibrahimit (a.s), që përmenden më lart.
3- Subhanallah, Elhamdulilah, Allahu Ekber.

AI ËSHTË ALLAHU I CILI ËSHTË ZOTI I VETËM DHE NUK KA TJETËR PËRVEÇ TIJ

هُوَ اللَّهُ الَّذِي لَا إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ

الرَّحْمَٰنُ	الرَّحِيمُ	الْمَلِكُ	الْقُدُّوسُ	السَّلَامُ	الْمُؤْمِنُ	الْمُهَيْمِنُ	الْعَزِيزُ	الْجَبَّارُ	الْمُتَكَبِّرُ
ERR-RRAHMÂN	ERR-RRAHÎM	EL-MELIK	EL-KUD-DÛS	ES-SELÂM	EL-MU'MIN	EL-MUHEJMIN	EL-AZÎZ	EL-XHEB-BÂR	EL-MUTEKEB-BIR
I Gjithëmëshirshmi	Mëshirëploti	Mbreti	I Shenjti	Paqedhënësi	Garantuesi i sigurisë	Mbizotëruesi	I Plotfuqishmi	Imponuesi	Madhështori
الْخَالِقُ	الْبَارِئُ	الْمُصَوِّرُ	الْغَفَّارُ	الْقَهَّارُ	الْوَهَّابُ	الرَّزَّاقُ	الْفَتَّاحُ	الْعَلِيمُ	الْقَابِضُ
EL-KHÂLIK	EL-BÂRI'U	EL-MUSAU-UIR	EL-GAF-FÂR	EL-KAH-HÂR	EL-UEH-HÂB	ERR-RRAZ-ZÂK	EL-FET-TÂH	EL-ALÎM	EL-KABID
Krijuesi	Zanafillësi	Formësuesi	Falësi i madh	Ngadhënjyesi	Dhuruesi i pashoq	Furnizuesi	Zgjidhjedhënësi	I Gjithëdituri	Shtrënguesi
الْبَاسِطُ	الْخَافِضُ	الرَّافِعُ	الْمُعِزُّ	الْمُذِلُّ	السَّمِيعُ	الْبَصِيرُ	الْحَكَمُ	الْعَدْلُ	اللَّطِيفُ
EL-BÂSIT	EL-KHÂFID	ERR-RRÂFIU	EL-MUIZ-Z	EL-MUDHIL-L	ES-SEMÎ'U	EL-BASÎR	EL-HAKEM	EL-ADL	EL-LATÎF
Dhuruesi i rrizkut	Nënshtruesi	Vlerësuesi i të përkushtuarve	Nderuesi i besimtarëve	Përçmuesi i jobesimtarëve	Dëgjuesi	Shikuesi	Gjykatësi	Ai që vendos drejtësinë	I Dhembshuri
الْخَبِيرُ	الْحَلِيمُ	الْعَظِيمُ	الْغَفُورُ	الشَّكُورُ	الْعَلِيُّ	الْكَبِيرُ	الْحَفِيظُ	الْمُقِيتُ	الْحَسِيبُ
EL-KHABÎR	EL-HALÎM	EL-ADHÎM	EL-GAFÛR	ESH-SHEKÛR	EL-ALIJ-J	EL-KEBÎR	EL-HAFIDH	EL-MUKÎT	EL-HASÎB
I Mirënjohuri	I Buti	I Madhërishmi	Falësi	Mirënjohësi	I Larti	I Madhi	Ruajtësi	Furnizuesi	Kërkuesi i llogarisë
الْجَلِيلُ	الْكَرِيمُ	الرَّقِيبُ	الْمُجِيبُ	الْوَاسِعُ	الْحَكِيمُ	الْوَدُودُ	الْمَجِيدُ	الْبَاعِثُ	الشَّهِيدُ
EL-XHELÎL	EL-KERÎM	ERR-RRAKÎB	EL-MUXHÎB	EL-UÂSIA	EL-HAKÎM	EL-UEDÛD	EL-MEXHÎD	EL-BÂITH	ESH-SHEHÎD
Përdëllimtari	Bujari	Mbikqyrësi	Pranuesi i lutjeve	Dhuruesi i pashoq	Gjykatësi i urtë	I Dashuri	Krenari	Ringjallësi i njerëzimit	Dëshmitari
الْحَقُّ	الْوَكِيلُ	الْقَوِيُّ	الْمَتِينُ	الْوَلِيُّ	الْحَمِيدُ	الْمُحْصِي	الْمُبْدِئُ	الْمُعِيدُ	الْمُحْيِي
EL-HAKK	EL-UEKÎL	EL-KAUJ	EL-METÎN	EL-UELIJ	EL-HAMÎD	EL-MUHSÎ	EL-MUBDI	EL-MUID	EL-MUHJI
I Vërteti	Rregulluesi	Fuqiforti	I Forti	Përkrahësi	I Falënderuari	Gjithëpërfshirësi	Filluesi i çdo gjëje	Rikrijuesi	Ringjallësi
الْمُمِيتُ	الْحَيُّ	الْقَيُّومُ	الْوَاجِدُ	الْمَاجِدُ	الْوَاحِدُ	الْأَحَدُ	الصَّمَدُ	الْقَادِرُ	الْمُقْتَدِرُ
EL-MUMÎT	EL-HAJ-J	EL-KAJ-JÛM	EL-UÂXHID	EL-MÂXHID	EL-UÂHID	EL-EHAD	ES-SAMED	EL-KÂDIR	EL-MUKTEDIR
Marrësi i shpirtrave	I Gjalli	I Përjetshmi	I Mjaftueshmi	I Lavdëruari	Një dhe i Vetëm	Një dhe Unik	Strehuesi i nevojtarëve dhe mbajtësi i tyre	I Gjithëpushtetshmi	Përcaktuesi
الْمُقَدِّمُ	الْمُؤَخِّرُ	الْأَوَّلُ	الْآخِرُ	الظَّاهِرُ	الْبَاطِنُ	الْوَالِي	الْمُتَعَالِ	الْبَرُّ	التَّوَّابُ
EL-MUKAD-DIM	EL-MUAKH-KHIR	EL-EU-UEL	EL-ÂKHIR	EDH-DHÂHIR	EL-BÂTIN	EL-UÂLI	EL-MUTEÂLÎ	EL-BERR-RR	ET-TEU-UÂB
I Pari pa fillim	I Fundit pa mbarim	I Pari	I Fundit	I Dukshmi	I Padukshmi	Udhëheqësi	Shumë i Lartësuari	Bamirësi i pashoq	Pranuesi i pendimit
الْمُقْسِطُ	الْجَامِعُ	الْغَنِيُّ	الْمُغْنِي	ذُو الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ		مَالِكُ الْمُلْكِ	الرَّءُوفُ	الْعَفُوُّ	الْمُنْتَقِمُ
EL-MUKSIT	EL-XHÂMI	EL-GANIJ	EL-MUGNÎ	DHUL-XHELÂLI UEL IKRÂM		MÂLIKUL MULK	ERR-RRAÛF	EL-AFU'U	EL-MUNTEKIM
I Drejti që mbron të pafajshmit	Tubuesi	I Pasuri	I Panevojshëm për asgjë	Poseduesi i nderimit dhe bujarisë		Mbreti i çdo pushteti	Shumë i dhembshur	Falësi i madh	Hakmarrësi
الصَّبُورُ	الرَّشِيدُ	الْوَارِثُ	الْبَاقِي	الْبَدِيعُ	الْهَادِي	النُّورُ	النَّافِعُ	الضَّارَّ	الْمَانِعُ
ES-SABÛR	ERR-RRASHÎD	EL-UÂRITH	EL-BÂKÎ	EL-BEDÎ'A	EL-HADÎ	EN-NÛR	EN-NÂFI'A	ED-DÂRR-RR	EL-MÂNI'
Durimtari	Frymëzuesi	Trashëgimtari	I Përjetshmi	Shpikësi	Udhëzuesi	Drita	Dobisjellësi	Dëmtuesi i atyre që e meritojnë ndëshkimin	Privuesi

Mësimi 2

EDUKATA ME FENË

Edukata me fenë

- Jam krenar që jam musliman
- Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami
- Islami është feja e Allahut

Islami është feja e:

- paqes
- butësisë
- mëshirës
- lehtësimit
- të gjithë njerëzimit
- natyrës së pastër

Islami është feja më e mirë

Në orën e edukatës islame:

Mësuesi: Ardit, sa fe ka në botë?

Arditi: Ka aq shumë fe, saqë është e vështirë të numërohen.

Mësuesi: Zejnep, a janë të gjitha fetë të vërteta?

Zejnepi: Jo mësues, të gjitha fetë janë të gabuara, përveç njërës.

Mësuesi: Hatixhe, cilat janë tre fetë, të cilave Allahu u ka shpallur libër?

Hadixhja: Hebraizmi, Krishterimi dhe Islami.

Mësuesi: Osman, cila nga këto fe është feja e vërtetë?

Osmani: Feja islame mësues.

Mësuesi: Përse?

Shemsiu: Për shkak se Islami është e vetmja fe, të cilën e ka ruajtur Allahu.

Mësuesi: Ju lumtë fëmijë.

Dialog:

Ismaili: Mami, çfarë duhet të bëjë një njeri, nëse dëshiron të bëhet musliman?

Mami: Duhet të thotë Shehadetin.

Ismaili: Si thuhet Shehadeti?

Mami: Esh'heduen la ilahe il la llah ue esh'hedu en-ne Muhameden abduhu ue resuluhu"

Ismaili: Cili është kuptimi i Shehadetit?

Mami: "Dëshmoj se nuk zot tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Allahut"

Ismaili: Faleminderit mami. Allahu ta shpërbleftë me të mira.

Kushtet e Islamit

1- Shehadeti
2- Namazi
3- Zekati
4- Agjërimi i Ramazanit
5- Haxhi një herë në jetë për atë që ka mundësi.

- Feja islame flet për besimin
- Feja islame flet për adhurimin
- Feja islame flet për moralet e mira
- Feja islame rregullon marrëdhëniet e njeriut me Allahun
- Feja islame rregullon marrëdhëniet e njeriut me të tjerët
- Feja islame rregullon marrëdhëniet e njeriut me veten e tij.

Disa nga urdhëresat e fesë islame:

- Adhuroje Allahun!
- Fale namazin!
- Jepe Zekatin!
- Agjëroje Ramazanin!
- Kryeje Haxhin!
- Sillu mirë me prindërit!
- Ji njeri i drejtë dhe i sinqertë!
- Mbaje besën dhe amanetin!



Disa nga ndalesat e fesë islame:

- Mos adhuro askënd tjetër përveç Allahut!
- Mos u sill keq me prindërit!
- Mos vidh!
- Mos gënje!
- Mos luaj bixhoz!
- Mos ha mish derri!
- Mos pi alkol dhe duhan!
- Mos ji mendjemadh!
- Mos e thyej besën dhe amanetin!

Hadith:

Njëherë Profeti (a.s) u tha shokëve të tij:
"Feja është këshillë".
Shokët e pyetën: "Për kë është këshillë"?
Profeti (a.s) tha:
"Për Allahun.
për Librin e Tij
për të Dërguarin e Tij
për të parët e muslimanëve (udhëheqësit)
dhe për të gjithë muslimanët".



Dialog:

Gjyshi: Eh si janë bërë njerëzit sot, pa din dhe pa iman"
Selmani: Gjysh, çfarë do të thotë: "Pa din dhe pa iman"?
Gjyshi: Po ja "Pa din dhe pa iman" do të thotë një njeri pa fe dhe pa besim.
Selmani: Gjysh, çfarë mund të bëjë një njeri "Pa din dhe pa iman"
Gjyshi: Gjithë të këqijat.
Selmani: Për shembull?
Gjyshi: Një njeri i tillë e shan Zotin dhe fenë e tij. Një njeri i tillë nuk i bindet Allahut dhe as urdhërave të Tij. Një njeri i tillë i bindet vetëm tekave të tij, shejtanit dhe urdhrave të tij.

Selmani: Sa keq qenka të jesh "Pa din dhe pa iman", gjyshi!
Gjyshi: Është e vërtetë nipi im i dashur, prandaj ne duhet të jetojmë me "din dhe iman"

Dialog:

Sara: Mami, çfarë ndodh me njeriun, pasi varroset?
Mami: I vijnë dy engjëj - Munkeri dhe Nekiri - dhe i bëjnë 3 pyetje.
Sara: Çfarë pyetjesh?
Mami: Kush është Zoti yt? Cila është feja jote dhe cili është Profeti yt?
Sara: Po si përgjigjet njeriu?
Mami: Nëse është besimtar, thotë: "Zoti im është Allahu, feja ime është Islami dhe Profeti im është Muhamedi (a.s)"
Sara: Po ai që është jobesimtar, a i përgjigjet këtyre pyetjeve?

Mami: Jo nuk i përgjigjet dot këtyre pyetjeve.
Sara: Po përgjigja është shumë e thjeshtë!
Mami: Është e thjeshtë për ne që jemi besimtarë, ndërsa jobesimtari e ka të pamundur të përgjigjet. Prandaj ne duhet të falenderojmë Allahun, i Cili na ka bërë muslimanë.
Sara: Elhamdulilah

Radijtu bil lahi
rab ben
Ue bil islami dinen
Ue bi Muhamedin
nebij jen ue resulen

Jam i kënaqur
me Allahun si Zot,
me Islamin si fe
me Muhamedin (a.s) si
profet dhe të dërguar

Edukata ime me fenë islame:

- Unë e dua fenë time.
- Unë i respektoj urdhrat e fesë.
- Unë adhuroj vetëm Allahun.
- Unë e fal namazin.
- Unë agjëroj Ramazanin.
- Unë lexoj Kuran.
- Unë sillem mirë me prindërit.
- Unë them gjithmonë të vërtetën.

ARGËTIM DHE ZBAVITJE

A E DINI SE:

Kush e shpiku sapunin? Atë e shpiku Al-Xhazeri ne shekullin e 13-të. Sapuni i parë ishte një përzierje mes vajit të ullirit dhe një kripe si substancë. Këto dy përbërje përziheshin së bashku dhe krijonin sapunin.

Një ilustrim nga një dorëshkrim tregon sistemin e zbuluar nga Al-Jazari për tu larë dhe pastruar.

Kuiz:

Si i ka dhëmbët qeni i zi, kur lind?

Përgjigja: Qeni i zi lind pa dhëmbë

Gjëegjëzë:

Janë shumë nuse
Me buzë të kuqe

(fijet e shkrepëses)

Për të qeshur:

Vëllai: Mami, Genti po ha gazetën
Mamaja: Nuk ka gjë, se gazeta e djeshme është.

Gjej ndryshimet:

Ushtrime

Ushtrimi 1: Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!
1- Cila është feja e vërtetë tek Allahu i Lartësuar?
2- Cilat janë tre pyetjet, që engjëjt ia bëjnë njeriut në varr?
3- Cilat janë përgjigjet, që njeriu u jep engjëjve kur e pyesin në varr?
4- Çfarë do të thotë "Pa din dhe iman"?
5- Thuaj disa urdhëresa të fesë!
6- Thuaj disa ndalesa të fesë!

Ushtrimi 2 : Plotëso vendet bosh!
1- Adhuroje .....
2- Feja islame flet për.....
3- Jam i ..... me Allahun si ..... me ..... si fe dhe ..... si të Dërguar.
4- Dy engjëjt që i vijnë njeriut në varr janë ..... dhe .....
5- Mos ..... dhe mos .....
6- Esh'hedu en la ..... Il ..... ue esh'hedu en-ne Muhameden ..... ue .....

Ushtrimi 3: Si kanë vepruar këta fëmijë? Vendos shenjën ✓ ose x për çdo rast.

- ☐ Albani ha mish derri.
- ☐ Kastrioti pi verë
- ☐ Sulejmani po fal namazin
- ☐ Alisa gënjen
- ☐ Isra sillet mirë me prindërit
- ☐ Luti adhuron vetëm Allahun
- ☐ Shabani do të kryejë Haxhin këtë vit
- ☐ Iliri shan fenë

Ushtrimi 4: Mëso përmendësh!

1- Shehadetin arabisht dhe shqip.
2- Pesë shtyllat e Islamit.
3- Urdhëresat dhe ndalesat e fesë, që janë përmendur më lart.

Mësimi 3

EDUKATA ME PROFETIN (A.S.)

Esh'hedu en-ne
Muhameden
abduhu ue resuluhu!

Dëshmoj se Muhamedi
është rob dhe i
Dërguar i Allahut!

Ky është Profeti Muhamed (a.s):

- Profeti Muhamed (a.s) është profeti i fundit, të cilin Allahu e dërgoi për mbarë njerëzimin.
- Profeti Muhamed (a.s) u tregoi njerëzve rrugën e drejtë.
- Profeti Muhamed (a.s) erdhi me mesazhin, që i nxjerr njerëzit nga errësirat në dritë.
- Profeti Muhamed (a.s) është ai, i cili na mësoi fenë islame.
- Profeti Muhamed (a.s) është adhuruesi më i mirë.
- Profeti Muhamed (a.s) është njeriu me moralin dhe sjelljen më të mirë.

Allahu e cilëson Muhamedin (a.s) në Kuran me epitete fisnike:

- I dërguar
- Profet
- I mbështjellë

- I mbuluar
- Rob i Allahut
- Me moral të lartë

Dialog:

Jasmina: Selamu alejkum!
Medina: Ue alejkum selam!
Jasmina: Çfarë duhet të themi, kur ta përmendim emrin e Profetit Muhamed?
Medina: Unë gjithmonë them: "Alejhi selam", kur përmend emrin e Profetit.
Jasmina: Çfarë do të thotë: "Alejhi selam"?
Medina: Paqja e Allahut qoftë me të.
Jasmina: Sa herë që do ta dëgjoj apo ta përmend do të them: "Alejhi selam". Allahu ta shpërbleftë me të mira Medina.
Medina: Amin edhe ty gjithashtu.

Shokët e Profetit Muhamed (a.s):

- Shokët e Profetit Muhamed (a.s) quhen sahabë.
- Shokët e Profetit Muhamed (a.s) besuan në profetësinë e tij (a.s).
- Shokët e Profetit Muhamed (a.s) e donin shumë atë (a.s).
- Shokët e Profetit Muhamed (a.s) e respektonin shumë atë (a.s).
- Shokët e Profetit Muhamed (a.s) e dëgjonin shumë atë (a.s).
- Shokët e Profetit Muhamed (a.s) i bindeshin urdhrave të tij (a.s).
- Shokët e Profetit Muhamed (a.s) nuk e thërrisnin asnjëherë në emër atë (a.s).
- Shokët e Profetit Muhamed (a.s) nuk e ngrinin zërin në praninë e tij (a.s).
- Shokët e Profetit Muhamed (a.s) e mbrojtën dhe luftuan krah për krah me të (a.s).

Allahu thotë në Kuran:

"Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu, tek Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun".

Profeti (a.s) ka thënë:

"Faluni ashtu sikurse më shikoni mua"!

"Mësoni prej meje rregullat e Haxhit"!

"Kush dërgon një salavat për mua,
Allahu dërgon 10 salavate për të".

"Vërtet Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me selam".

Salavatet:

Allahumme sal li ala Muhamedin
ue ala ali Muhamedin
Kema sal lejte ala Ibrahim ue
ala ali Ibrahim.
In neke hamidun mexhid.

Allahumme barik ala Muhamedin
ue ala ali Muhamedin
Kema barekte ala Ibrahim
ue ala ali Ibrahim.
In neke hamidun mexhid.

Përkthimi:

O Zot bekoje Muhamedin
dhe familjen e tij
siç e bekove Ibrahimin
dhe familjen e tij.
Ti je i Falenderuar
dhe i Lartësuar.

O Zot begatoje Muhamedin
dhe familjen e tij
siç e begatove Ibrahimin
dhe familjen e tij
Ti je i Falenderuar
dhe i Lartësuar.

Në orën e mësimit të edukatës islame, Enesi mësoi se salavatet duhet të lexohen:

- Sa herë që përmendet emri i Profetit Muhamed (a.s)
- Pas thirrjes së ezanit
- Gjatë namazit, në uljen e fundit
- Kur hyn dhe del nga xhamia
- Gjatë faljes së namazit të xhenazes
- Gjatë lutjes
- Në ditën e Xhuma

Edukata ime me Profetin (a.s):

- Unë dëshmoj dhe besoj në profetësinë e Muhamedit (a.s)
- Unë e dua dhe e respektoj Profetin Muhamed (a.s)
- Unë i bindem urdhrave të Profetit Muhamed (a.s)
- Unë e ndjek rrugën, që ndoqi Profeti Muhamed (a.s)
- Unë bie në salavatë për Profetin Muhamed (a.s), sa herë që e dëgjoj emrin e tij
- Unë e mbroj figurën dhe personalitetin e Profetit Muhamed (a.s)
- Unë e lexoj dhe e mësoj jetën e Profetit Muhamed (a.s)

ARGËTIM DHE ZBAVITJE

A E DINI SE:

Kush e shpiku parfumin?

Atë e shpiku Al-Kindi. Ai ishte nga Kufa, qytet në Irak. Ai njihej si filozof, fizikant, farmacist, okulist, matematicien, gjeograf, astronom dhe kimist.

Kuiz:

Çfarë bën kinezi, kur bie shi?

Përgjigja: E lë të bjerë

Gjëegjëzë:

Është porsi çadër
Me një këmbë rri
Fushave të gjera
Del kur bie shi

(kërpudha)

PËR TË QESHUR:

Në klasë
Mësuesi: Ku është Genti?
Beni: Mungon..
Mësuesi: Pusho, le ta thotë vetë Genti se mungon.

Ngjyros figurat

PROFETIN MUHAMED ËSHTË MODELI IM MË I MIRË PËR MORALIN DHE SJELLJEN TIME

Ushtrime

Ushtrimi 1: Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!

1- Kush është modeli më i mrekullueshëm, që duhet marrë si shembull?
2- Kush është Profeti Muhamed (a.s)?
3- Kur duhet t'i themi salavatet?
4- Sa është shpërblimi i atij që këndon një salavat?
5- Çfarë duhet të themi, kur e përmendim emrin e Profetit Muhamed?

Ushtrimi 2: Plotëso vendet bosh!

1- Profeti Muhamed (a.s) është ..... i fundit për mbarë njerëzimin.
2- Dëshmoj se Muhamedi (a.s) është ..... dhe .....
3- Profeti Muhamed (a.s) është ai, i cili na mësoi ..... islame.
4- Profeti Muhamed (a.s) u tregoi njerëzve rrugën e .....
5- Shokët e Profetit (a.s) e ..... dhe e ..... atë.
6- Allahu e cilëson Profetin (a.s) me epitetin I D..... dhe P.....

Ushtrimi 3: Si kanë vepruar këta fëmijë? Vendos shenjën ✓ ose x për çdo rast.

- ☐ Kenza çon salavate për Profetin (a.s) në ditën e Xhuma.
- ☐ Albi nuk thotë "alejhi selam", kur dëgjon emrin e Profetit Muhamed (a.s).
- ☐ Geni beson në Profetësinë e Muhamedit (a.s).
- ☐ Mateo falet, siç është falur Profeti Muhamed (a.s).
- ☐ Beni e shan me fjalë të këqija Profetin Muhamed (a.s).
- ☐ Isra ka shumë dëshirë të lexojë për jetën e Profetit Muhamed (a.s).
- ☐ Sara i bindet urdhrave të Profetit Muhamed (a.s).

Ushtrimi 4: Mëso përmendësh!

1- Epitetet e Profetit Muhamed (a.s)!
2- Salavatet në shqip dhe arabisht!
3- Rastet kur thuhen salavatet!

Shkruaj në vendin e duhur në foto kohët e namazit.

Sabahu
Dreka
Ikindia
Akshami
Jacia



Mësimi 4

EDUKATA ME KURANIN

القرآن الكريم

Edukata me Kuranin

Kurani është Libri i Allahut (xh.sh), të cilin ia zbriti

Profetit Muhamed (a.s), nëpërmjet engjëllit Xhebrail (a.s)

Dialog:

Amari: Gjyshi, cili është libri i fundit që ka zbritur Allahu?
Gjyshi: Kurani.
Amari: Përse e ka zbritur Allahu Kuranin?
Gjyshi: Allahu e ka zbritur Kuranin, për t'i udhëzuar njerëzit në rrugë të drejtë.
Amari: Për çfarë flet Kurani?
Gjyshi: Kurani flet për besimin tek Allahu, besimin në botën tjetër, adhurimin e Zotit, moralin e lartë, historitë e profetëve dhe largimin nga veset e këqija.
Amari: Sa sure ka Kurani?
Gjyshi: 114.
Amari: Cila është surja e parë dhe surja e fundit e Kuranit?
Gjyshi: Surja e parë e Kuranit titullohet "Fatiha", kurse surja e fundit titullohet "Nas"
Amari: Allahu ta shpërbleftë me të mira.

Lukmani i dha këto këshilla djalit të tij:

- Biri im! Mos i shoqëro Allahut askënd në adhurim!
- Biri im! Nderoji dhe respektoji prindërit!
- Biri im! Falenderoje Zotin dhe prindërit!
- Biri im! Allahu e di të fshehtën.
- Biri im! Fale namazin!
- Biri im! Urdhëro për mirë dhe ndalo nga e keqja!
- Biri im! Bëhu i durueshëm!
- Biri im! Mos u trego mendjemadh dhe mos i përbuz njerëzit!
- Biri im! Ec me kujdes dhe fol me zë të ulët!

Profeti Muhamed (a.s) ka thënë:

"Lexoni Kuran, sepse ai do të jetë ndërmjetësues në Ditën e Gjykimit!"
"Më i miri prej jush është ai, i cili e mëson Kuranin dhe ua mëson atë të tjerëve".
"Kush lexon Kuran, për çdo gërmë ka 10 sevape".

Kur lexohet Kurani, besimtarit

- i rrënqethet trupi
- i qetësohet zemra
- i kënaqet shpirti
- i shtohet besimi



- Ibrahimi po merr abdes për të lexuar Kuran
- Shabani po lexon Kuran
- Hatixheja po mëson Kuran përmendësh
- Sonila po dëgjon Kuran
- Babai po pastron dhëmbët, para se të lexojë Kuran

❖ Lejla është një nxënëse shembullore.
❖ Lejla është një lexuese e mirë e Kuranit.
❖ Lejla merr abdes, para se të lexojë Kuranin.
❖ Lejla vesh rrobat më të bukura dhe më të hijshme, para se të lexojë Kuranin.

❖ Lejla drejtohet nga Kibla, para se të lexojë Kuranin.
❖ Lejla thotë: "Eudhu bil lahi minesh shejtanir raxhim. Bismilahir rahmanir rahim", para se të lexojë Kuranin.
❖ Lejla ka zë të bukur dhe të mrekullueshëm.
❖ Lejla e puth Kuranin, para se të fillojë leximin dhe pasi ta lexojë atë.

Në orën e edukatës islame, Asija mësoi se

- Ajo si fillim duhet të mësojë abetaren e gjuhës arabe.
- Ajo duhet të mësojë ta lexojë Kuranin me rregullat e texhvidit
- Ajo duhet të bëjë sexhde, sa herë që lexon një ajet sexhdeje.
- Ajo duhet t'i lutet Allahut. që t'i dhurojë Xhenetin, sa herë që lexon një ajet që flet për Xhenetin.
- Ajo duhet t'i kërkojë Allahut, që ta ruajë nga Xhehenemi, sa herë që lexon një ajet, që flet për Xhehenemin.



Ajo duhet ta madhërojë Allahun, sa herë që lexon një ajet, që flet për atë që ka krijuar Allahu.

Ajo duhet t'i kërkojë falje Allahut, sa herë që lexon një ajet, që flet për pendimin.

Vjershë për Kuranin



Kuranin kur e lexoj
Më duket se në qiell fluturoj
Të gjithë planetet i vizitoj

Ejani fëmijë, Kuranin ta mësojmë
Si engjëj në qiell të gjithë të fluturojmë

Kurani është drita, si dielli në pranverë
Nëpër zemrat tona të mbetet përherë

Kurani është drita që shndrit shpirtin tim
vetëm në Kuran s'mund të gjejmë gabim

Kuran i dashur, ne ty të lexojmë
në duar të mbajmë, në tokë s'të lëshojmë

Kuran i bekuar, je si uji i detit
nëpërmjet Xhebrailit i zbrite Muhamedit.

Kujdes!!! Kurrë mos i bëj veprimet e mëposhtme!!!

- Të lexosh Kuran pa abdes.
- Të mos e dëgjosh Kuranin me vëmendje.
- Ta lësh Kuranin në dysheme.
- Ta mbash Kuranin në qese tek kroskoti i makinës.
- Të grisësh disa faqe të Kuranit.
- Të shkruash me stilolaps në ndonjë faqe të Kuranit.
- Ta lësh Kuranin të mbulohet nga pluhuri.
- Të mos e lexosh Kuranin për periudha të gjata kohore.
- Ta shkelësh Kuranin me këmbë.

Edukata ime me Kuranin:

- Unë marr abdes, përpara se të lexoj Kuran.
- Unë them "Eudhu Bilahi minesh shejtanir raxhim" dhe "Bismilahirr-rrahmanirr-rrahim", përpara se të lexoj Kuran.
- Unë përpiqem që ta lexoj Kuranin me rregulla.
- Unë përpiqem, që ta zbukuroj zërin gjatë leximit të Kuranit.
- Unë dëgjoj me vëmendje, kur lexohet Kurani.
- Unë përpiqem t'i zbatoj mësimet e Kuranit.

ARGËTIM DHE ZBAVITJE

A E DINI SE:



Kush e shpiku rubi- kubin?

Atë e shpikën vëllezërit Benu Musa në shekullin e 9-të. Ata ishin matematicienë dhe përkthyes të broshurave shkencore nga gjuha greke.

Kuiz:

Çfarë bën viçi, kur mbush 2 vjeç

Përgjigja: Hyn për 3.

Gjëegjëzë:

Ka kokrra si orizi
Por me ngjyrë ari
Është gëzimi i jetës
Në familjen e çdo fshatari

(gruri)

Për të qeshur:

Genti: Më jepni 2 litra qumësht lope.
Shitësi: Por në këtë shishe është e pamundur që të zërë 2 litra qumësht lope.
Genti: Mirë, atëherë më jep 2 litra qumësht deleje.

Sa trekëndësha gjenden në këtë figurë?



Ushtrime

Ushtrimi 1: Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!

1- Cili është Libri i fundit, që Allahu ka zbritur për njerëzimin?
2- Sa sure ka Kurani?
3- Çfarë këshillash i dha Lukmani të birit?
4- A duhet të jetë muslimani me abdes, kur të lexojë Kuran?
5- Çfarë duhet të themi, përpara se të lexojmë Kuran?
6- Për çfarë flet Kurani?

Ushtrimi 2 : Plotëso vendet bosh!

1- Surja e parë e Kurani titullohet ..... kurse ajo e fundit titullohet .....
2- Kur lexohet Kurani, trupi .....
3- Më i miri prej jush është ai, i cili e ..... Kuranin dhe ua mëson atë të .....
4- Kush lexon Kuran, për çdo gërmë ka ..... sevape.
5- Lejla e ..... Kuranin, para se të fillojë leximin dhe pasi ta lexojë atë.
6- Nderoji dhe respektoji .....!

Ushtrimi 3: Si kanë vepruar këta fëmijë? Vendos shenjën ✓ ose x për çdo rast.

- ☐ Sokoli lexon Kuran çdo ditë.
- ☐ Shqipja ha bukë, kur lexon Kuran.
- ☐ Tedi nuk ka dëshirë fare të lexojë Kuran.
- ☐ Fabi mësoi përmendësh 10 suret e fundit të Kuranit.
- ☐ Sildi po dëgjon Kuran.
- ☐ Dori pështyn mbi Kuran.
- ☐ Erva lexon Kuran, duke qenë me abdes.

Ushtrimi 4: Mëso përmendësh!

1- Përkufizmin e Kuranit!
2- Vjershën për Kuranin!
3- Dhjetë suret e fundit të Kuranit!

Diskutoni me babin dhe mamin rreth zbulimit të konceptit të aparatit fotografik të parë nga Ibn al-Haytham



Mësimi 5

EDUKATA E DHIKRIT

(PËRMENDJES SË ALLAHUT)

Allahu thotë në Kuran:

"O besimtarë, përmendeni sa më shumë Allahun"

Profeti (a.s) ka thënë:

"Dallimi midis atij që përmend Allahun dhe atij që nuk e përmend është si dallimi mes të gjallit dhe të vdekurit.

Dialog:

Selimi: Babi, dua të të bëj një pyetje.
Babai: Urdhëro!
Selimi: Çfarë është dhikri?
Babai: Të përmendësh Allahun.
Selimi: Kush na ka mësuar, që ta përmendim Allahun me dhikër?

Babai: Allahu në Kuran dhe Profeti Muhamed (a.s) në fjalët e tij
Selimi: Kur mund të bëjmë dhikër?
Babai: Në çdo kohë dhe çast.
Selimi: Faleminderit babi. Unë dua të bëj dhikër tani
Babai: Shumë mirë. Hadje të fillojmë... Subhanallah...

Kur bëjmë Dhikër:

- Engjëjt na mbulojnë me krahët e tyre
- Na përfshin mëshira e Zotit
- Na qetësohen zemrat
- Allahu na përmend lart në qiell
- Allahu na ngre në grada të larta

Dhikri është më i mirë se ari dhe argjendi

Disa fukarenj shkuan tek Profeti Muhamed (a.s) dhe i thanë:
"O i Dërguar i Allahut! Të pasurit na e kaluan".
Profeti (a.s) pyeti: "Përse"?
"Po ja - thanë fukarenjtë -, ata falen sikurse ne, agjërojnë si ne, por ata japin nga pasuria e tyre, kurse ne nuk kemi mundësi".
Profeti (a.s) tha: "Allahu jua ka dhënë edhe juve këtë mundësi"!
Fukarenjtë pyetën: "Si"?
Profeti (a.s) tha: "Duke thënë: Subhanallah, Elhamdulilah, Allahu Ekber, La ilahe il Allah".

Fjala "Elhamdulilah" e mbush peshoren.

"Subhanallah" dhe "Elhamdulilah" mbushin hapësirën midis qiejve dhe Tokës.

Dialog:

Mësuesi: Asllan, kur themi "Subhanallah"?
Asllani: Kur shohim një krijim të Allahut.
Mësuesi: Selma, kur themi "Elhamdulilah"?
Sumeje: Kur duam të falenderojmë Allahun.

Mësuesi: Esma, kur themi "Allahu Ekber"?
Esma: Kur duam ta madhërojmë Allahun.
Mësuesi: Enis, kur themi "Estagfirullah".
Enisi: Kur duam t'i kërkojmë falje Allahut.
Mësuesi: Hasan, kur themi "Inshallah"?
Hasani: Kur duam të bëjmë një punë në të ardhmen.

Sulejmani direkt pas faljes së namazit thotë:

- Estagfirullah (3 herë)
- Subhanallah (33 herë)
- Elhamdulilah (33 herë)
- Allahu Ekber (33herë)

Më pas, mund të lexojë edhe suret:

- Ihlas
- Felek
- Nas

Mos e ço dëm kohën tënde, por shfrytëzoje atë duke përmendur Allahun.

Ndiqni në Youtube këto kanale islame për fëmijë

Edukata ime e dhikrit:

- Unë them "Subhanallah" çdo ditë
- Unë them "Elhamdulilah" çdo ditë
- Unë them "Allahu ekber" çdo ditë
- Unë them "Estagfirullah" çdo ditë
- Unë them "Subhanallahi ue bihamdihi" çdo ditë
- Unë them "Subhanallahil Adhim" çdo ditë
- Unë them "La Ilahe il lallah" çdo ditë
- Unë them "Allahum-me sal-li ala Muhamed" çdo ditë.

ARGËTIM DHE ZBAVITJE

A E DINI SE:

Njëmijë vite para vëllezërve Right, poeti, astronomi dhe inxhinieri musliman me emrin Abas ibn Firnas, tentoi të ndërtojë makinën e parë fluturuese, me të cilën njeriu do të ngjitej në hapësirat qiellore, njësoj si zogjtë.

Kuiz:

Në një pemë gjenden 5 zogj. Gjahtari qëllon me pushkë dhe vret 1 zog. Sa zogj ngelen në pemë?

Përgjigja: Asnjë, sepse zogjtë fluturojnë.

Gjëegjëzë:

Është e vogël punëtore
Gjithë verën ajo punon
Mbush folenë e saj me drith
E në dimër nis këndon

(Milingona)

Për të qeshur:

Mamaja: Genti përse i ke thyer të gjitha vezët?
Genti: Nuk i kam thyer unë, por i ka thyer shitësi.
Mamaja: Përse?
Genti: Kur shkova në dyqan i thashë shitësit: "Sa kushton një kokër vezë"?
Shitësi: 140 lekë.
Genti: Po një vezë e thyer?
Shitësi: 40 lekë.
Genti: Atëherë më jep 10 kokra vezë të thyera

Gjeji fjalët e mëposhtme:

Allah, Islam, Muhamed, Dhikri, Kurani, Zekat, Haxhi.

K	U	R	A	N	I	B	R	U	T
N	D	I	C	F	I	S	L	A	M
Y	X	Dh	I	K	R	I	Th	Ll	E
I	R	Th	P	O	Z	Sh	A	A	K
M	U	H	A	M	E	D	K	H	S
E	K	B	S	C	K	O	Z	Y	Zh
P	O	U	I	H	A	Xh	I	T	B
U	Y	Z	Nj	K	T	Y	D	Rr	Y

Ushtrime

Ngjyrosni figurat



Ushtrimi 1: Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!

1- Cili është dallimi midis atij njeriu që e përmend Allahun dhe atij që nuk e përmend Atë?
2- Çfarë është Dhikri?
3- Çfarë duhet të themi direkt pas faljes së namazit?
4- Kur duhet të themi "Subhanallah".
5- Çfarë përfitojmë nga historia e fukarenjve, të cilët shkuan tek Profeti Muhamed (a.s)?
6- Cilat janë gjërat, që na humbin kohën dhe na largojnë nga Dhikri?

Ushtrimi 2: Plotëso vendet bosh!

1- Dhikri është ..... e Allahut.
2- Elhamdulilah themi, kur duam të ..... Allahun.
3- Kur bëjmë Dhikër ..... na mbulojnë me krahët e tyre.
4- Mos e ço dëm kohën tënde, por shfrytëzoje atë duke bërë .....
5- Fjala ..... e mbush peshoren.
6- .....themi, kur duam të bëjmë një punë në të ardhmen.

Ushtrimi 3: Si kanë vepruar këta fëmijë? Vendos shenjën ✓ ose

x për çdo rast.

- ☐ Tomi bën gjithmonë Dhikër.
- ☐ Taulanti thotë "Bismilah", para se të hajë bukë.
- ☐ Besa nuk bën asnjëherë Dhikër.
- ☐ Sonila thotë "Elhamdulilah" sapo mbaron së ngrëni.
- ☐ Brukli thotë "Inshallah", kur shikon një gjë të bukur.
- ☐ Desara bën Dhikër me zë shumë të lartë.
- ☐ Shpresa e përjeton me gjithë zemër Dhikrin.

Ushtrimi 4: Mëso përmendësh!

1 – Fjalinë: "Subhanallah" dhe "Elhamdulilah" mbushin hapësirën midis qiejve dhe tokës".
2 – Tregimin e fukarenjve që shkuan tek Profeti (a.s)
3 – Dhikrin që thuhet pas namazit.



Diskutoni me babin dhe mamin rreth Al-Khwarizmi dhe zbulimeve që ka bërë ai.

Mësimi 6

EDUKATA E LUTJES

Allahu thotë në Kuran:

"E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes së lutësit, kur lutësi më lutet. Prandaj, le t'i përgjigjen thirrjes Time dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë".

- Lutja është adhurim.
- Lutja është përulësi ndaj Allahut.
- Lutja është përgjërim.
- Lutja është arma më e fortë e besimtarit.
- Lutja kthen mbrapsht caktimin e Allahut.

Dialog:



Samiri: Babi, a është e vërtetë, se një peshk i madh ka gëlltitur një profet?
Babai: Po është e vërtetë.
Samiri: Cili është ai Profet?
Babai: Junusi (a.s)
Samiri: Çfarë ndodhi me Junusin (a.s), kur ishte në barkun e peshkut?
Babai: Junusi u lut me këto fjalë: "La ilahe il la ente subhaneke in ni kuntu minedh dhalimin"
Samiri: Çfarë do të thotë kjo lutje?
Babai: "Nuk ka zot tjetër përveç Teje, i Lartësuar qofsh, unë i bëra padrejtësi vetes time"
Samiri: Po pastaj, çfarë ndodhi me Junusin (a.s)?
Babai: Allahu i dha urdhër peshkut, që ta nxirrte Junusin (a.s) në breg dhe ai shpëtoi.
Samiri: Cili ishte shkaku, që Allahu e shpëtoi Junusin (a.s) nga barku i peshkut?
Babai: Lutja me të cilën ai (a.s) iu drejtua Allahut.
Samiri: Sa mirë. Atëherë edhe unë do t'i lutem Allahut me këtë lutje, kur të jem në vështirësi.

Ja si e fillon Ahmedi lutjen:

"O Zot të lutem nëpërmjet emrave të Tu të bukur
Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë për Profetin Muhamed
O Zot më jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër"

Tregim:

Njëherë, tre shokë u nisën në një udhëtim dhe i zuri nata rrugës.
Ata vendosën të flinin brenda një shpelle.
Pasi u futën brenda, papritur ra një gur i madh, i cili e bllokoi hyrjen e shpellës.
Shokët vendosën t'i luteshin Allahut nëpërmjet një pune të mirë që kishin bërë.
I pari kishte respektuar prindërit
I dyti ishte larguar nga vesi i keq i imoralitetit
I treti ia kishte dhënë hakun punëtorit të tij
Kështu Allahu i shpëtoi ata, për shkak të këtyre veprave të mira, që kishin bërë.

Omeri lutet me këto fjalë:

- O Zot më udhëzo në rrugën e drejtë!
- O Zot ma forco besimin!
- O Zot më bëj prej pasuesve të rrugës së Profetit (a.s)!
- O Zot pranoji adhurimet e mia!
- O Zot më jep suksese në shkollë!
- O Zot lehtëso dhe mos vështirëso!
- O Zot më fal mua, prindërit e mi dhe të gjithë besimtarët!
- O Zot më bëj prej banorëve të Xhenetit!
- O Zot më ruaj nga Zjarri i Xhehenemit!

Dialog:

Aliu: Mami, Jusra është mërzitur me mua.
Mami: Jusra!
Jusra: Urdhëro mami!
Mami: Përse je mërzitur me Aliun?
Jusra: Unë e dua Aliun, por...
Mami: Por çfarë?
Jusra: Ai çdo ditë më kërkon gjëra dhe unë jam mërzitur shumë prej tij.
Mami: Ali!
Aliu: Urdhëro mami!
Mami: Mësoje njëherë e mirë, se kur ti kërkon çdo ditë prej njerëzve nga një gjë, vjen një ditë që ata mërziten me ty, ndërsa kur i lutesh Allahut, Ai asnjëherë nuk mërzitet me ty, sado që t'i lutesh Atij.
Aliu: Faleminderit mami. Këtë mësim nuk kam për ta harruar kurrë.

Momentet më të mira për lutje janë:

- Kur je në sexhde
- Midis ezanit dhe ikametit
- Në pjesën e fundit të natës
- Të Xhumanë
- Gjatë Ramazanit, veçanërisht në natën e Kadrit
- Gjatë leximit të Kuranit dhe pasi e përfundon leximin e gjithë Kuranit
- Kur bie shi
- Para pirjes së ujit të Zemzemit

Në orën e edukatës islame, Jashari mësoi se:

- Ai duhet t'i lutet vetëm Allahut dhe askujt tjetër
- Ai duhet të jetë këmbëngulës në lutje
- Ai duhet ta përjetojë me gjithë shpirt lutjen
- Ai duhet t'i ngrejë duart gjatë lutjes
- Ai duhet ta ulë zërin, kur lutet
- Ai duhet të thotë "Amin" në fund të lutjes.

Profeti (a.s) ka treguar
për një njeri, i cili i ishte lutur Allahut,
por Ai nuk i ishte përgjigjur lutjes së tij.

Arsyeja: Ky person ishte ushqyer,
kishte pirë dhe ishte
veshur me haram



Këta fëmijë kanë vepruar gabim:

- Ahmedi lutet vetëm për veten e tij
- Jurgeni lutet në teqe
- Ismeti nuk beson, se Allahu do t'i përgjigjet lutjes së tij
- Mustafai mallkon të tjerët, kur lutet
- Ismaili i thotë Amirit: "Vdeksh"!
- Daudi e ngre zërin, kur lutet
- Saimiri nuk i ngre duart, kur lutet
- Shuajbi nuk lutet asnjëherë

Edukata ime gjatë lutjes:

- Unë i lutem vetëm Allahut.
- Unë jam i bindur, se Allahu do t'i përgjigjet lutjeve të mia.
- Unë drejtohem nga Kibla, kur lutem.
- Unë jam me abdes, kur lutem.
- Unë e ul zërin, kur lutem.
- Unë lutem gjithmonë.
- Unë lutem me përgjërim dhe shpresë.

ARGËTIM DHE ZBAVITJE

A E DINI SE:

Qysh në shekullin e XI, të gjithë shkencëtarët muslimanë deklaronin, se toka ka formë sferike. Ata i shfaqën argumentet e tyre në lidhje me këtë, 500 vite para Galileos.

Kuiz:

Gjeli i bardhë bëri një vezë. Çfarë ngjyre kishte veza?

Përgjigja: Gjeli nuk bën vezë

Gjëegjëzë:

E hapur si kërpudhë
E mbyllur si qiri
Me qindra sheh në udhë
Kur nis e bie shi

(çadra)

Për të qeshur:

Mësuesi: Genti më përmend shtatë kafshë të egra?
Genti: Luani, ujku dhe pesë tigra.

Labirinth

Ndihmoni Benin dhe Anën të shkojnë në Xhami.



Ushtrime

Ushtrimi 1: Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!

1- Cili është ai Profet, të cilin e ka gëlltitur peshku i madh?
2- Allahu është afër apo larg, kur njeriu i lutet Atij?
3- Trego tre përfitime nga tregimi i shokëve, të cilët mbetën të mbyllur në shpellë!
4- Kur janë momentet më të mira për të bërë lutje?
5- A mërzitet Allahu, kur ti i lutesh Atij?
6- Çfarë duhet të themi në fund të lutjes?

Ushtrimi 2 : Plotëso vendet bosh!

1- Lutja është .....
2- Lutja është ..... më e fortë e besimtarit.
3- ..... të lutem nëpërmjet ..... të Tu të bukur.
4- O Zot më udhëzo në rrugën e .....
5- O Zot më jep ..... në shkollë.
6- Gjatë lutjes, duhet t'i ngremë .....

Ushtrimi 3: Si kanë vepruar këta fëmijë? Vendos shenjën ✓ ose x për çdo rast.

- ☐ Romina i lutet Allahut me përgjërim.
- ☐ Loreta e ngre zërin kur lutet.
- ☐ Ramadani nuk i ngre duart kur lutet.
- ☐ Durimi thotë "Amin", përpara se të lutet.
- ☐ Bamiri e falenderon Allahun, përpara se të lutet.
- ☐ Ergi i lutet Allahut, që ta ndihmojë në provim.
- ☐ Selina lutet në teqe.

Ushtrimi 4: Mëso përmendësh!

1- Lutjen e Junusit (a.s), kur ai ishte në barkun e peshkut.
2- Tregimin e tre shokëve që u bllokuan në shpellë.
3- Momentet më të mira, kur njeriu i lutet Allahut.

Mësimi 7

EDUKATA E PASTËRTISË

Pastërtia është gjysma e besimit
Pastërtia është gjysma e shëndetit



Dialog:

Mësuesja: Të gjithë muslimanët adhurojnë vetëm një Zot.
Kristi: Të krishterët adhurojnë gjithashtu vetëm një Zot.
Mësuesja: Të krishterët adhurojnë Jezu Krishtin dhe ai nuk është Zot, por njeri.
Benjamini: Hebrenjtë adhurojnë gjithashtu vetëm një Zot.
Mësuesja: Hebrenjtë e shajnë Zotin.
Raxhi: Hindusët adhurojnë gjithashtu vetëm një Zot.
Mësuesja: Hindusët adhurojnë lopën dhe jo Zotin.
Uangu: Kinezët adhurojnë gjithashtu vetëm një Zot.
Mësuesja: Kinezët adhurojnë Budën dhe jo Zotin.
Arsi: Të gjithë njerëzit në botë adhurojnë vetëm një Zot.
Mësuesja: Dëgjoni me kujdes fëmijë! Zoti është Një i Vetëm. Ai është i Pastër nga të metat, që ia përshkruajnë njerëzit.

Zemra e pastër:

- Zemra nuk duhet të dyshojë tek çështjet e besimit
- Zemra duhet t'i kushtohet vetëm Allahut
- Zemra duhet të jetë e pastër nga zilia
- Zemra duhet të jetë e pastër nga urrejtja
- Zemra duhet të jetë e pastër nga syfaqësia
- Zemra duhet të jetë e pastër nga egoja

Suada është një vajzë e mirë dhe e edukuar.
Ajo sillet mirë me të gjithë.
Ajo ka një veti shumë të mirë.
Sa herë gabon, ajo dëshiron ta shlyejë gabimin, por nuk di se si të veprojë.
Për këtë arsye, ajo pyeti gjyshen, e cila i tha:
"Suada! Në rradhë të parë, ti duhet të pendohesh tek Allahu! Më pas, kërkoji falje personit, ndaj të cilit ke gabuar dhe menjëherë pas kësaj, bëj një punë të mirë"!

Brenda në shtëpi:

- Mami lan rrobat
- Gjyshja fshin pluhurat
- Babai hap dritaret
- Gëzimi ngre jorganët
- Zana hekuros rrobat
- Luljeta pastron dyshemenë
- Jeta lan dritaret
- Besimi lyen këpucët me bojë

Jashtë shtëpisë:

- Mami fshin oborrin
- Gjyshi derdh plehrat në koshin e mbeturinave
- Sameti mbjell një pemë
- Sara fshin klasën
- Sejda lan klasën
- Ermali pastron xhaminë
- Desa mban pastër zyrën e saj
- Jashari lyen me gëlqere muret e shkollës

Si mund ta mbaj ambientin të pastër?

- Hidhi mbeturinat në kosh e jo sa andej - këndej!
- Mos e lër ujin të derdhet kot!
- Hape dritaren e dhomës për ajrim!
- Mbill një pemë...

Profeti Muhamed (a.s) i kushtonte shumë rëndësi pastërtisë.
Profeti Muhamed (a.s) i lante duart para dhe pas ushqimit.
Profeti Muhamed (a.s) i lante dhëmbët me misvak.
Profeti Muhamed (a.s) vishte rroba të pastra.
Profeti Muhamed (a.s) i mbulonte enët, që mos të ndoteshin.
Profeti Muhamed (a.s) kujdesej për pastrimin e zemrës.

Ndotja e ambientit



Në testin e edukatës, Ajni mori notën 10.

Këto janë përgjigjet e pyetjeve të testit:

Pyetja 1: Përse duhet të pastrohen flokët?

Përgjigja: Me qëllim që të largosh papastërtitë.

Pyetja 2: Çfarë duhet të bësh, kur të rriten thonjtë?

Përgjigja: Duhen prerë.

Pyetja 3: Çfarë duhet të bësh, kur hyn në shtëpi?

Përgjigja: Duhet të lash duart dhe këmbët.

Pyetja 4: Çfarë duhet të bësh para dhe pas buke?

Përgjigja: Duhet të lash duart.

Pyetja 5: Sa herë në ditë duhen larë dhëmbët?

Përgjigja: 2–3 herë në ditë, veçanërisht kur të vjen erë e keqe nga goja.

Pyetja 6: Kur duhet të bësh dush?

Përgjigja: Sa herë që e ndjen se trupi është djersitur dhe mban erë të pakëndshme.

Pyetja 7: Përse fytyra duhet larë më shpesh?

Përgjigja: Sepse fytyra bëhet pis më shpesh.

Dialog:



Ermiri: Ooou...Ooou...Ooou...
Agroni: Çfarë ke?
Ermiri: Kam dhimbje barku.
Agroni: Çfarë ke ngrënë?
Ermiri: Mollë që i bleva në pazar.
Agroni: A i ke larë?
Ermiri: Jo.
Agroni: Ke vepruar gabim.
Ermiri: Përse?
Agroni: Ato duhet të lahen sepse nëse i ha të palara, të shkaktojnë dhimbje barku.
Ermiri: Nuk e dija.
Agroni: Allahu të shëroftë.
Ermiri: Amin dhe faleminderit për këshillën.

Zaidja shkoi bashkë me mamin në supermarket.
Ajo bleu disa gjëra shumë të rëndësishme për higjenën.
Ajo bleu detergjent për larjen e rrobave dhe të pllakave.
Ajo bleu furçë dhe pastë dhëmbësh.
Ajo bleu shampo me erë të mirë.
Ajo bleu aromatizues për rrobat.
Ajo bleu anti-djersë.
Ajo bleu prerëse thonjsh.
Ajo bleu leckë për enët.



Kur besimtari merr abdes, ai:

- Lan duart deri në kyçe
- Shpërlan gojën
- Shpërlan hundën
- Lan fytyrën
- Lan krahët deri në bërryla
- Fshin kokën dhe veshët
- Lan këmbët deri në nyje

Kështu ai pastron gjymtyrët dhe njëkohësisht pastrohet nga mëkatet.

Edukata e pastërtisë në tualet

1. Themi: "Allahum me in ni eudhu bike minel khubthi uel khabaith"

"O Allah, kërkoj mbrojtje prej xhindëve meshkuj dhe femra"

2. Pastaj hyjmë në banjo me këmbën e majtë
3. Nevojat personale i kryejmë ulur
4. Duhet të bëjmë kujdes, që të mos i ndotim rrobat
5. Nuk hamë, nuk pimë e as nuk flasim
6. Pastrohemi me ujë të bollshëm
7. Pastrohemi me dorën e majtë
8. Pastrojmë tualetin me ujë
9. Lajmë duart me sapun
10. Dalim me këmbën e djathtë
11. Duke thënë: "Gufraneke"

"Më fal o Zot!"

Veprime të gabuara. Kujdes!!!

- Gimi nuk i pret thonjtë.
- Desara zhgarravit muret e shtëpisë.
- Resmija mban erë të keqe, ngaqë nuk lahet.
- Arjani fshin hundët me dorë.
- Shkëlqimi i hedh mbeturinat në tokë.
- Ana nuk i lan asnjëherë dhëmbët.
- Demiri fle gjumë me këmbë të palara.
- Zoja nuk i lan duart para dhe pas bukës.
- Ervisi urinon gjithmonë në këmbë.
- Klajdi fishkëllen në tualet.

Edukata ime e pastërtisë:

- Unë besoj dhe adhuroj vetëm Allahun
- Unë e pastroj zemrën nga urrejtja
- Unë pastrohem nga mëkatet, duke u penduar
- Unë e mbaj pastër ambientin që më rrethon
- Unë i mbaj rrobat të pastra
- Unë gjithmonë i laj duart, para dhe pas buke
- Unë i laj këmbët, sa herë që hyj në shtëpi
- Unë gjithmonë i laj dhëmbët
- Unë i laj frutat dhe perimet, para se t`i ha
- Unë gjithmonë i pres thonjtë
- Unë e pastroj shtëpinë
- Unë i hedh mbeturinat në kosh
- Unë pastrohem, pasi kryej nevojat personale në tualet

ARGËTIM DHE ZBAVITJE

A E DINI SE:

Kush i shpiku tapetet?

Për herë të parë ato u krijuan nga fiset beduine të Arabisë, Persisë dhe Anatolisë. Ato përdoreshin si tenda, për t`u mbrojtur nga stuhitë e rërës dhe për t'u ulur.

Kuiz:

Katër burra u hodhën në pishinë. Njërit prej tyre nuk iu lagën flokët. Përse?

Përgjigja: Sepse ishte deros

Gjëegjëzë:

Mendje s'ka, por të mëson
Gojë s'ka, por me ty flet
Ti përditë me të jeton
Mik të ngushtë e ke përjetë

(Libri)

Për të qeshur:

Në test:
Mësuesi: Kush është kryeqyteti i Shqipërisë?
Genti: Tirana
Mësuesi: Sa banorë ka Tirana?
Genti: Rreth një milion banorë.
Mësuesi: Më thuaj emrat e gjithë banorëve të Tiranës.

Gjej 7 ndryshimet



Ushtrime

Ushtrimi 1: Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!

1- Nga se duhet të jetë e pastër zemra?
2- Si duhet të pastrohet Suada nga gabimi?
3- Si mund ta mbajmë ambientin pastër?
4- Si e ndotin ambientin njerëzit?
5- Çfarë duhet të bësh para dhe pas buke?
6- Përse Zaidja bleu gjithë ato gjëra në supermarket?

Ushtrimi 2 : Plotëso vendet bosh!

1- ..... është gjysma e besimit.
2- Zoti është ..... i Vetëm dhe i ..... nga të metat.
3- Zemra duhet t'i kushtohet vetëm .....
4- Luljeta ..... shtëpinë.
5- Shkëlqimi ..... mbeturinat në tokë.
6- ..... një pemë.

Ushtrimi 3: Si kanë vepruar këta fëmijë? Vendos shenjën ✓ ose x për çdo rast.

☐ Dona hedh lëvoren e bananes në rrugë.
☐ Sajmiri mbjell një pemë.
☐ Iliri hedh letrat e patatinave nga dritarja e shtëpisë.
☐ Gerti merr një mbeturinë nga rruga dhe më pas e hedh në koshin e plehrave.
☐ Daku nuk ka dëshirë t'i presë thonjtë.
☐ Omeri i lan këmbët, sapo hyn në shtëpi.
☐ Artani nuk e lë ujin të derdhet kot.

Ushtrimi 4: Mëso përmendësh!

1- Formën se si Profeti Muhamed (a.s), pastronte trupin dhe zemrën!
2- Edukatën e pastërtisë në tualet!
3- Dobitë e abdesit!

Diskutoni me babin dhe mamin për kompleksin e mrekullueshëm Al-Hambra në Spanjë.

Mësimi 8

EDUKATA E EZANIT

Allahu thotë në Kuran:
"Kush respekton shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij"



- Ezani është rit madhështor i fesë
- Ezani është thirrje për namaz
- Ezani largon shejtanin
- Ezani është shkak për faljen e mëkateve
- Ezani është shkak për të hyrë në Xhenet

- Muezini ka qafën më të gjatë në Ditën e Gjykimit.
- Të gjithë krijesat dëshmojnë për muezinin.
- Muezini është njeri i dalluar tek Allahu.
- Profeti (a.s) ka kërkuar falje për muezinin.
- Muezinit i falen mëkatet.
- Muezini që e thërret ezanin për 12 vjet rresht, hyn në Xhenet.

Dialog:



Arsi: Babi, përse xhamitë kanë minare?
Babai: Sepse ato janë simbol i fesë islame.
Arsi: Për çfarë shërbejnë minaret?
Babai: Minaret shërbejnë, që zëri i ezanit të dëgjohet sa më larg.
Arsi: Sa minare mund të ketë një xhami?
Babai: Zakonisht xhamia ka vetëm një minare, por mund të ketë edhe më tepër.
Arsi: Sa minare ka Qabja?
Babai: Qabja ka 9 minare.
Arsi: Faleminderit babi. Allahu ta shpërbleftë me të mira.

Dialog:

Hatixhja: Mami, Allahu thotë në Kuran "Dhe ta ngritëm lart emrin" Për kë flet ky ajet kuranor?
Mami: Për Profetin Muhamed (a.s)
Hatixhja: Po si është ngritur lart emri i Profetit (a.s)?
Mami: Po ja, çdo musliman që thotë Shehadetin, e përmend emrin e Profetit (a.s)
Hatixhja: Pra sa herë që muezini thërret ezanin, e përmend emrin e Profetit (a.s)
Mami: Bravo, shumë e vërtetë.
Hatixhja: Oh faleminderit mami, që më bëre ta kuptoj këtë ajet kuranor.

Një ditë, Profeti (a.s) dhe shokët e tij ishin mbledhur dhe po diskutonin për mënyrën se si do t'i thërrisnin njerëzit për namaz

Dikush tha: "T'i biem burisë"

Profeti (a.s) tha: "Jo, sepse kështu u ngjajmë çifutëve".

Një tjetër tha: "T'i biem këmbanës".

Profeti (a.s) tha: "Jo, sepse kështu u ngjajmë të krishterëve".

Një i tretë tha: "Të ndezim zjarr".

Profeti (a.s) tha: "Jo, sepse kështu i ngjajmë atyre që e adhurojnë zjarrin".

Atë ditë të gjithë dhanë nga një mendim, por nuk arritën në një përfundim të përbashkët.

Kështu shokët e Profetit (a.s) u shpërndanë nëpër shtëpitë e tyre.

Të nesërmen, njëri prej tyre shkoi tek Profeti (a.s) dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut! Kam parë në ëndërr të thirren njerëzit për namaz kështu e ashtu (me ezan)".

Profeti (a.s) i tha Bilalit (r.a): "Çohu dhe thirri njerëzit për namaz me këto fjalë"!

Kur Omeri (r.a) e dëgjoi këtë, shkoi dhe i tha Profetit (a.s): "Të njëjtën gjë kam parë edhe unë në ëndër".



Në kohën e Profetit (a.s), ezanin e thërrisnin dy persona: Abdullahu (r.a) dhe Bilali (r.a)
Profeti (a.s) i thoshte Bilalit (r.a): "Na qetëso me ezan, o Bilal"
Bilali (r.a) çohej, e thërriste ezanin dhe Profeti (a.s) kënaqej.
Pasi Profeti (a.s) ndërroi jetë, Bilali (r.a) nuk e thërriti më ezanin.
Njëherë disa shokë iu lutën, që ta thërriste përsëri ezanin.
Bilali (r.a) u çua dhe filloi të thërriste ezanin
Kur arriti tek "Esh'hedu en ne Muhameden Resulullah", ngeci. u mek dhe filloi të qante me ngashërim.
Bilali (r.a) u përpoq disa herë që të vazhdonte, por...
Qysh nga ajo ditë, Bilali (r.a) nuk e thirri më ezanin

Forma e thirrjes së ezanit

Allahu Ekber (4 herë)
Esh'hedu en la ilahe il lallah (2 herë)
Esh'heduen ne Muhameden resulullah (2 herë)
Haj je ales salah (2 herë)
Haj je alel felah (2 herë)
Es salatu hajrun minen neum (vetëm në sabah - 2 herë)
Allahu Ekber (2 herë)
La ilahe il lallah (1 herë)

Përkthimi:
Allahu është më i madhi
Dëshmoj se nuk zot tjetër përveç Allahut
Dëshmoj se Muhamedi është Profet i Allahut
Hajdeni të falni namazin
Hajdeni në shpëtim
Namazi është më i mirë se gjumi
Allahu është më i madhi
Nuk ka zot tjetër përveç Allahut

Dialog:

Muizi: Mësues çfarë duhet të bëjmë, kur thirret ezani?
Mësuesi: Duhet ta dëgjojmë me vëmendje dhe të përsërisim fjalët që thotë muezini.
Sherifja: Po kur muezini të thotë: "Haj je ales salah, Haj je alel felah", çfarë duhet të themi?
Mësuesi: "La haule ue la ku uete il la bil lah"
Selimi: Po kur muezini në mëngjes thotë: "Es salatu hajrun minen neum" çfarë duhet të themi?
Mësuesi: "Sadakte ue bererte"
Selma: Po pas ezanit çfarë duhet të themi?
Mësuesi: Lutjen përkatëse që thuhet pas ezanit, salavate për Profetin (a.s) dhe lutje për veten tonë dhe muslimanët.



Lutja që thuhet pas ezanit

Allahum me rab be hadhihid dauetit tam meh
Ues salatil kaimeh
Ati Muhamedenil uesilete uel fadilete
Ued derexhete rrafiah
Ueb'ath'hume kamen mahmudenil
Ledhi ueattehu
In neke la tuhliful miad

Përkthimi:

O Allah, Zoti i kësaj thirrjeje të plotë dhe namazit që po afrohet
Jepi Muhamedit ndërmjetësimin, vlerën dhe gradën e lartë
dhe dërgoje atë në vendin e lavdëruar, të cilin ia ke premtuar,
sepse Ti nuk e thyen premtimin.

Edukata ime gjatë thirrjes së ezanit:

- Unë e dëgjoj me vëmendje ezanin.
- Unë i përsëris fjalët e muezinit.
- Unë nuk bëj zhurmë, kur thirret ezani.
- Unë bëj duanë përkatëse pas thirrjes së ezanit.
- Unë bëj salavate për Profetin (a.s) pas thirrjes së ezanit.
- Unë lutem pasi thirret ezani.
- Unë fal 2 rekate nafile, pasi thirret ezani.



ARGËTIM DHE ZBAVITJE

A E DINI SE:

Kur u krijua shkolla e parë? Para mijëra vitesh xhamia ishte shkollë për muslimanët. Shkolla e parë u krijua ne vitin 653 ne Arabinë Saudite.

Kuiz:

Një zog ndodhet në një degë peme. Duam të presim degën po pa e trembur zogun. Si veprojmë?

Përgjigja: Presim derisa zogu të largohet vetë.

Gjëegjëzë:

Mbi dy brigje qëndron shtrirë
Këmbët në ujë ngulur mirë
Përmbi të makinat shkojnë
Nën të ujërat gurgullojnë

(ura)

Për të qeshur:

Genti: Kam harruar çadrën time në shtëpi
Beni: Si u kujtove që e ke harruar?
Genti: Bëja ta mbyllja kur mbaroi shiu, por pashë që nuk e kisha.

Bashko pikat
dhe pastaj ngjyros!



Ushtrime

Ushtrimi 1: Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!

1- Çfarë është ezani?
2- Për çfarë shërbejnë minaret?
3- Si është ngritur lart emri i Profetit Muhamed (a.s)?
4- Përse Bilali (r.a) nuk e thirri më ezanin?
5- Çfarë duhet të bëjë besimtari, kur dëgjon ezanin?
6- Zëri i muezinit duhet të jetë i bukur apo i shëmtuar?

Ushtrimi 2 : Plotëso vendet bosh!

1- Ezani është thirrje për .....
2- ..... ka qafën më të gjatë në Ditën e Gjykimit.
3- Qabja ka ..... minare.
4- Kam parë në ëndër të thirren njerëzit për namaz ..... e .....
5- ..... dhe ..... ishin dy muezinët, të cilët e thërrisnin ezanin në kohën e Profetit (a.s).
6- Qysh nga ajo ditë ..... nuk e thirri më ezanin.

Ushtrimi 3: Si kanë vepruar këta fëmijë? Vendos shenjën ✓ ose x për çdo rast.

- Agroni flet dhe bën zhurmë, kur thirret ezani.
- Amiri i përsërit fjalët që thotë muezini gjatë ezanit.
- Dafina thërret ezanin.
- Visi e thërret ezanin me zë të bukur.
- Irena bën duanë përkatëse pas ezanit.
- Berti e thërret ezanin për namaz, para se të hyjë koha e namazit.
- Aishja e thërret ezanin pa abdes.
- Bledi e thërret ezanin, duke qëndruar në këmbë.

Ushtrimi 4: Mëso përmendësh!

1- Ndodhinë për ezanin!
2- Formën e thirrjes së ezanit!
3- Duanë pas thirrjes së ezanit!

Mësimi 9

EDUKATA E NAMAZIT

Fale Namazin!

Vërtet namazi të mbron nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar.

- Namazi është lidhja e njeriut me Allahun.
- Namazi është shtyllë e Islamit.
- Namazi është dëshmi në Ditën e Gjykimit.
- Namazi është dritë.

Dialog:

Ismaili: Babi, Sa namaze duhet të falë muslimani në ditë?

Babai: Pesë namaze në ditë.

Ismaili: Kur është bërë namazi obligim për herë të parë?

Babai: Në natën e Israsë dhe Miraxhit.

Ismaili: A mund të ma shpjegosh pak?

Babai: Në këtë natë, Profeti (a.s) është ngritur sipër 7 qiejve dhe prej aty është urdhëruar me faljen e 50 namazeve në ditë.

Ismaili: Babi, por ne falemi vetëm pesë herë në ditë?!

Babai: Në fillim Profeti (a.s) u urdhërua të falte 50 namaze, por pastaj Allahu ia uli numrin dhe e urdhëroi të falte vetëm 5 namaze në ditë. Prandaj ne falim 5 namaze në ditë, por shpërblimin e kemi sa për 50 namaze.



Ismaili: Faleminderit babi.

Një ditë Profeti (a.s) i pyeti shokët e tij:

"Nëse një lumë kalon pranë shtëpisë tuaj dhe ju laheni në të pesë herë në ditë, a do të pastroheshit"? Ata thanë: "Po".

Profeti (a.s) tha: "Kështu është edhe çështja e namazit. Kur ju faleni pesë herë në ditë, pastroheni nga gjynahet".

- Profeti Ibrahim (a.s) e ka falur namazin.
- Profeti Ismail (a.s) e ka falur namazin.
- Profeti Musa (a.s) e ka falur namazin.
- Profeti Harun (a.s) e ka falur namazin.
- Profeti Zekerija (a.s) e ka falur namazin.
- Profeti Isa (a.s) e ka falur namazin.
- Profeti Muhamed (a.s) e ka falur namazin.
- Të gjithë profetët e Allahut (Paqja qoftë mbi ta) kanë falur namaz.

Pesë namazet e obligueshme janë

- Sabahu
- Dreka
- Ikindia
- Akshami
- Jacia

Muslimani i fal namazet në kohën e tyre

Sara merr abdes, para se të falë namazin



Kur muslimanët falen, drejtohen nga Kibla

Amina është veshur sipas rregullave të faljes

Dialog:

Shahini: Tahir, hajde të ikim në xhami!
Tahiri: Ik ti, sepse unë do të shkoj njëherë në shtëpi.
Shahini: Po përse do të ikësh në shtëpi?
Tahiri: Po ja, deri tani ne po luanim dhe rrobat e mia janë bërë pis, kështu që unë do të shkoj në shtëpi të ndërrohem, të vesh rroba të pastra dhe pastaj do të vij menjëherë në xhami.
Shahini: Ke shumë të drejtë, pasi edhe rrobat e mia janë bërë pis dhe nuk është mirë që të falemi me këto rroba të pista, prandaj edhe unë do të shkoj në shtëpi e të vesh rroba të pastra.
Tahiri: Hajde, le të shpejtojmë.

Kushtet që duhet të plotësohen para namazit:

1- Njeriu duhet të marrë abdes apo gusul, ose në mungesë të ujit të marrë tejemum.
2- Të drejtohet nga Qabja.
3- Trupi, rrobat dhe vendi ku do të falet, të jenë të pastra.
4- Pjesët e turpshme të trupit duhet të jenë të mbuluara. Pjesë e turpshme tek meshkujt konsiderohet nga kërthiza deri tek gjuri, kurse tek femrat i gjithë trupi përveç fytyrës dhe duarve e këmbëve deri në kyçe.
5- Të ketë hyrë koha e namazit përkatës.
6- Të bëjë nijetin për namazin që do të falë.

Kushtet (ruknet) që duhet të plotësohen gjatë faljes së namaz:

1- Tekbiri fillestar.
2- Qëndrimi në këmbë dhe leximi i Kuranit.
3- Rukuja.
4- Sexhdja.
5- Teshehudi i fundit
6- Përfundimi i namazit, duke dhënë selam në të dy krahët.

Gjërat që e prishin namazin:

1- Të hash apo të pish gjatë namazit.
2- Të flasësh diçka që nuk ka lidhje me namazin.
3- Të qeshësh me zë në namaz.
4- Të prishësh abdesin.
5- Të zbulosh auretin (pjesët intime).
6- Të bësh lëvizje të shumta që nuk janë pjesë e namazit.
7- Të mos kryesh një prej kushteve të namazit.

Edukata ime në namaz:



- Unë i drejtohem Allahut me gjithë zemër në namaz.
- Unë marr abdes, përpara se të fal namazin.
- Unë falem pesë herë në ditë.
- Unë jam i përpiktë në kohën e namazit.
- Unë iu përmbahem rregullave të namazit me kujdes dhe përkushtim.
- Unë shikoj në vendin e sexhdes, kur falem.
- Unë, përveç namazeve obligative, fal edhe namaze vullnetare (nafile).

ARGËTIM DHE ZBAVITJE

A E DINI SE:

Kur u krijua universiteti i parë islam?

Ai quhet universiteti El-Ez'her dhe u krijua në vitin 972. Sot e kësaj dite, ai njihet si universitet tradicional i botës islame.

Kuiz:

Si mund të futet ariu në frigorifer?

Përgjigja: Me 3 lëvizje: hap frigoriferin, fut ariun, mbyll frigoriferin.

Po luani?

Përgjigja: Me 4 lëvizje, sepse fillimisht duhet të heqësh ariun.

Gjëegjëzë:

Lind i madh

E vdes i vogël

(qiriu)

Për të qeshur:

Genti: Kam vendosur që të mos vë më bast.

Beni: Nuk e besoj.

Genti: E vëmë me bast.

Gjej sa katrorë janë këtu?



Ushtrime

Ushtrimi 1: Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!

1- Nga se të mbron namazi?
2- Sa namaze duhet të falë muslimani në ditë?
3- Cili prej profetëve e ka falur namazin?
4- Cilat janë pesë kohët e namazeve?
5- Përse muslimani duhet të marrë abdes, para se të falë namazin?
6- A e prish namazin e qeshura me zë?

Ushtrimi 2 : Plotëso vendet bosh!

1- Fale.....!
2- Namazi është lidhja e njeriut me .....
3- Kur ju faleni ..... herë në ditë, pastroheni nga gjynahet.
4- Të gjithë profetët e Allahut kanë falur .....
5- ..... është dritë.
6- Kur muslimanët falen, drejtohen nga .....

Ushtrimi 3: Çfarë kanë vepruar gabim fëmijët e mëposhtëm?

1- Alisa qesh, kur është duke u falur
2- Blerimi shikon me sy lart në tavan, kur është duke u falur
3- Kanita ha çamçakëz, kur është duke u falur
4- Muharremi kërcet gishtat, kur është duke u falur
5- Uarda kthen kokën sa djathas - majtas, kur është duke u falur
6- Shukriu u flet të tjerëve, kur është duke u falur.

Ushtrimi 4: Mëso përmendësh!

1- Pesë kohët e namazit!
2- Kushtet para dhe gjatë namazit!
3- Gjërat që e prishin namazin!

Ndihmoni haxhinjtë të shkojnë në Qabe



Mësimi 10

EDUKATA NË XHAMI

Allahu thotë në Kuran:



"Xhamitë i janë kushtuar vetëm Allahut,
prandaj mos iu lut askujt tjetër përveç Allahut".

Dialog:

Sara: Mami kush është xhamia e parë e ndërtuar në Tokë?
Mami: Qabja në Mekë.
Sara: Po pas saj?
Mami: Xhamia Aksa në Palestinë.
Sara: Kush e ka ndërtuar Qaben?
Mami: Qaben e kanë ndërtuar Ibrahimi (a.s) dhe Ismaili (a.s).
Sara: Po xhaminë Aksa, kush e ka ndërtuar?
Mami: Profeti Sulejman (a.s)
Sara: Faleminderit mami. Allahu ta shpërbleftë me të mira.



Allahu është i vetmi Zot i vërtetë
në qiell dhe në tokë
Bejtul Ma'mur në qiell
Qabja në tokë

- Kur shkon në xhami, për çdo hap që hedh të fshihet një gabim dhe fiton një shpërblim.
- Kush falet në xhami, fiton 27 shpërblime.
- Kush ndërton një xhami, Allahu i ndërton një shtëpi në Xhenet.
- Kush falet gjithmonë në xhami, në Ditën e Gjykimit do të jetë nën hijen e Fronit të Allahut.

- Vajzat po lexojnë Kuran në xhami

- Uejsi po lutet në xhami
- Osmani po falet në xhami
- Hamzai po bën dhikër në xhami

Dialog:

Babi: Ajni, për pak thirret ezani, hajde të ikim në xhami!

Ajni: Babi të lutem më prit pak, sa të marr abdes.

Babi: Pasi të falim namazin e akshamit, hoxha do të mbajë mësim.

Ajni: Për çfarë do të flasë?

Babi: Për vlerën e xhamisë.

Ajni: Sa mirë!

Babi: A more abdes?

Ajni: Po mora, tani mund të shkojmë në xhami.

Gruaja që pastronte xhaminë:

Në kohën e Profetit (a.s), jetonte një grua e varfër, që quhej Umu Mihxhen (r.a). Një ditë, Umu Mihxheni (r.a) pa, se xhamia e Profetit (a.s) ishte e papastër. Ajo mendoi: "Po sikur ta pastroj xhaminë"?! Dhe ashtu veproi. Qysh nga ajo ditë, Umu Mihxheni (r.a) e pastronte gjithmonë xhaminë e Profetit (a.s). Pas disa kohësh, Umu Mihxheni (r.a) u sëmur rëndë. Profeti (a.s) shkoi dhe e vizitoi atë në shtëpi. Kur Umu Mihxheni (r.a) ndërroi jetë, Profeti (a.s) iu lut Allahut, që ta mëshironte Umu Mihxhenin (r.a).

Duaja para hyrjes në xhami

Bismilah, ues salatu ues selamu ala resulilahi
Allahum mef`tah li ebuabe rahmetike

Përkthimi:

Me emrin e Allahut, Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin për të Dërguarin e Allahut. O Zot, m`i hap dyert e mëshirës Tënde.

Duaja pas daljes nga xhamia

Bismilahi ues salatu ues selamu ala resulilahi
Allahum me in nies'eluke min fadlike
Allahum me I'simni minesh shejtani rraxhim

Përkthimi:

Me emrin e Allahut. Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin për të Dërguarin e Allahut
O Zot, unë kërkoj nga mirësia Jote
O Zot, më mbro nga shejtani i mallkuar



Muhamedi shkoi bashkë me babain në xhami.
Muhamedi kishte marrë edhe celularin me vete.
Sa filloi të falte namazin bashkë me imamin,
Muhamedi dëgjoi një zile që binte.
Ishte zilja e celularit.
Obobo, ai kishte harruar ta fikte celularin
Zilja e celularit binte pa pushim
Kjo gjë e shqetësoi imamin dhe xhematlinjtë
Muhamedi u mërzit shumë.
Qysh nga ajo ditë, Muhamedi e ul zërin e celularit,
përpara se të falë namazin.

Edukata ime në xhami:

- Unë gjithmonë e fal namazin në xhami.
- Unë marr abdes, përpara se të shkoj në xhami.
- Unë lexoj Kuran në xhami.
- Unë i kërkoj falje Allahut, pasi fal namazin në xhami.
- Unë lutem në xhami.
- Unë i dëgjoj me vëmendje mësimet që jepen në xhami.
- Unë bëj dhikër në xhami.
- Unë i largoj papastërtitë që shikoj në xhami.
- Unë nuk i shqetësoj të tjerët, kur jam në xhami.

ARGËTIM DHE ZBAVITJE

A E DINI SE:

Kur u krijuan libraritë islame?

Ato u krijuan nga arabët, në shekullin VIII, ndërsa Kurani i ka zbritur Profetit Muhammed (a.s), në shekullin VII.

Kuiz:

Pse shtylla rri në këmbë?

Përgjigja: Se nuk ka karrige, ku të ulet.

Gjëegjëzë:

Pa derë pa penxhere
Jashtë e lyer me gëlqere

(veza)

Për të qeshur:

Në klasë:
Mësuesi: Genti thuaj disa kafshë të egra.
Beni: Luani (me zë të ulët)
Genti: Luani
Luli: Ariu (me zë të ulët)
Beni: Ariu.
Mësuesi: Genti, mos dëgjo shokët, por thuaje nga koka jote?
Genti, po mendohej, se çfarë kafshe kishte në kokë dhe pas pak bërtiti me zë të lartë "Pleshti, pleshti".

Gjej fjalët e mëposhtme!

Lutje, namazi, pastërtia, xhamia, qabja, sexhde

B	E	Xh	Th	O	Z	Ë	O	L	G
S	P	A	S	T	Ë	R	T	I	A
E	L	M	S	U	E	B	P	K	F
Xh	Xh	I	L	Q	Ë	V	L	N	R
D	N	A	M	A	Z	I	U	B	Ë
E	K	V	M	B	J	D	T	E	O
D	L	U	T	J	E	S	J	Z	I
U	I	Y	N	A	H	X	E	Y	F

Ushtrime

Ushtrimi 1: Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!

1- Kush është xhamia e parë, që është ndërtuar në Tokë?

2- Si quhet xhamia në qiell?

3- Sa sevape fiton ai që falet në xhami?

4- Si quhej gruaja, e cila pastronte xhaminë e Profetit (a.s)?

5- Kush e ka ndërtuar Qaben?

6- A duhet të bëjë njeriu zhurmë në xhami dhe përse?

Ushtrimi 2 : Plotëso vendet bosh!

1- ..... i janë kushtuar vetëm Allahut.

2- Xhaminë Aksa e ka ndërtuar Profeti ..... (a.s)

3- Allahu është i Vetmi Zot në ..... dhe në .....

4- Kush ndërton një ....., Allahu i ndërton një ..... në Xhenet.

5- Qysh nga ajo ditë, Umu Mihxheni (r.a) e pastronte gjithmonë ..... e Profetit (a.s)

6- Hoxha do të flasë për ..... e xhamisë.

Ushtrimi 3: Si kanë vepruar këta fëmijë? Vendos shenjën ✓ ose x për çdo rast.

- ☐ Hatixhja lexon Kuran në xhami.
- ☐ Indriti bën zhurmë në xhami.
- ☐ Sabriu po falet në xhami, pasi ka ngrënë hudhra.
- ☐ Elisi hyn me këmbë të lagura në xhami.
- ☐ Zenepja pastron xhaminë.
- ☐ Betimi vesh rroba të bukura, kur shkon në xhami.
- ☐ Sokoli qesh, kur falet në xhami.
- ☐ Jasmina vrapon në xhami.
- ☐ Albani dëgjon me vëmendje mësimet që mbahen në xhami.

Ushtrimi 4: Mëso përmendësh!

1- Rreth vlerës së xhamisë!

2- Lutjen kur hyn në xhami!

3- Lutjen kur del nga xhamia!

Mësimi 11

EDUKATA E AGJËRIMIT

Allahu thotë në Kuran:

"O ju të cilët keni besuar. Agjërimi ju është bërë detyrë, ashtu siç ka qenë edhe për ata para jush, me qëllim që të bëheni të devotshëm".

Dialog:

Mësuesi: Arbër, cili është shtylla e katërt i Islamit?
Arbri: Agjërimi i muajit të Ramazanit.
Mësuesi: Selma, çfarë do të thotë agjërim?
Selma: Agjërim do të thotë, të mos hash dhe të mos pish nga koha e syfyrit deri në kohën e iftarit.
Mësuesi: Mirel, për kë agjëron muslimani?
Mireli: Muslimani agjëron vetëm për hir të Allahut të Madhëruar.
Mësuesi: Asije, cili është shpërblimi i atij që agjëron?
Asija: Shpërblimi i atij që agjëron është vetëm tek Allahu i Madhëruar, i Cili shpërblen pa kufi.

Mësuesi: Nxënës të dashur, nesër është Ramazan, a do të agjëroni?
Nxënësit (njëzëri): Po
Mësuesi: Allahu na mundësoftë agjërimin e këtij muaji të begatë.
Nxënësit (njëzëri): Amin

Dialog:

Gjyshi: Fëmijë të dashur, nesër fillon Ramazani. A do të agjëroni?
Fëmijët: Po gjysh, ne kemi shumë dëshirë të agjërojmë.
Gjyshi: Ajni, në çfarë ore është syfyri dhe iftari?
Ajni: Syfyri është në 4:35 minuta, kurse iftari është në 16:40.
Fatima: Unë do të agjëroj pa syfyr, sepse nuk mund të zgjohem aq herët
Gjyshi: Jo. jo...Fatima, ne duhet të zgjohemi për të ngrënë syfyr, sepse bereqeti është tek ngrënia e syfyrit.
Amri: Gjysh, unë do ta çel iftarin, pasi të fal namazin e jacisë.
Gjyshi: Jo nipi im i dashur, ne duhet ta çelim iftarn menjëherë sa të fillojë muezini të thërrasë ezanin e Akshamit.
Fatima: Me çfarë duhet ta çelim iftarin?
Gjyshi: Me tre hurma arabe, ose me ujë.
Ajni: Çfarë duhet të bëjmë pas syfyrit?
Gjyshi: Duhet të marrim abdes, mund të falim dy rekate namaz në shtëpi dhe pastaj duhet të shkojmë në xhami për të falur namazin e sabahut.
Amri: Po për iftar, çfarë duhet të bëjmë?
Gjyshi: Menjëherë pasi ta çelim iftarin, duhet të bëjmë duanë përkatëse, pastaj duhet të falim akshamin. Më pas hamë iftarin dhe bëhemi gati për të shkuara në xhami, që të falim namazin e Jacisë dhe teravitë. Hajde tani, shkojmë të flemë, sepse nesër do të zgjohemi herët!

Dialog:

Mami: Aishe përse po qan?
Aishja: Po qaj, ngaqë m`u prish agjërimi
Mami: Përse?
Aishja: Shkova tek frigoriferi, mora një shishe ujë dhe piva, duke harruar që isha agjëruar.

Mami: Ti mund ta vazhdosh agjërimin, sepse nuk të është prishur.
Aishja: Përse, nuk më është prishur agjërimi mami?
Mami: Kush ha apo pi gjatë agjërimit nga harresa, le ta dijë se Allahu e ka ushqyer dhe i ka dhënë të pijë, prandaj mos qaj dhe vazhdoje agjërimin.
Aishja: Faleminderit mami.

Në orën e edukatës islame, nxënësit mësuan se gjërat që e prishin agjërimin janë:

- Të ngrënët me qëllim.
- Të pirët me qëllim.
- Provokimi i të vjellit me qëllim.
- Marrja e ilaçeve nga goja.



Gjatë agjërimit, muslimani duhet të largohet nga:

- Ngrënia dhe pirja e qëllimshme
- Fjalët e pahijshme
- Gënjeshtra
- Sharjet
- Ofendimet
- Sjellja e keqe me njerëzit

Punë të mira gjatë muajit Ramazan

- Agjërimi i sinqertë vetëm për Allahun
- Leximi i Kuranit
- Dhikri (të përmendësh Zotin)
- Duaja (lutja)
- Falja e namazit të teravisë dhe namazit të natës

Duaja e iftarit

Allahum me leke sumtu
Ue bike amentu
Ue ala rizkike eftartu
Dhehebetidh dham'a
Ue bteletil uruk
Ue thebetul exhru inshaellah

Përkthimi:

O Zot për ty kam agjëruar
Tek Ti kam besuar
Me begatinë Tënde po çel iftar.
Etja kaloi
venat u lagën
dhe inshalla shpërblimi u arrit.

Iliri kishte vendosur të agjëronte muajin e Ramazanit.
Ai e filloi agjërimin me një vendosmëri të madhe, por diku aty nga mesdita ai filloi të kishte etje dhe uri.

Ai hyri në dhomë, ku nuk e shikonte askush, hëngri e piu dhe më pas doli nga dhoma.

Kur erdhi koha e iftarit, babai e pyeti Ilirin, nëse kishte agjëruar. Iliri u përgjigj: "Po".

Si ka vepruar Iliri dhe përse?

Allahu thotë në Kuran:

1- Ne e kemi zbritur Kuranin në natën e Kadrit.
2- E kush mund të ta shpjegojë ty, se çfarë është nata e Kadrit?
3- Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj.
4- Engjëjt dhe Xhebraili, me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet.
5- Paqe është ajo, deri në lindjen e agimit.
(Sure Kadr)

Duaja në 10–të ditëshin e fundit të Ramazanit

Allahum me inneke afu'un kerimun
Tuhibbul afue
Fa'fu an ni

Përkthimi:

O Zot Ti je Falës, Bujar
E do faljen
Më fal mua.

Abdullah ibn Amri (r.a) ishte djalosh i ri dhe dëshironte të agjëronte
Profeti (a.s) i tha: "Agjëro tre ditë në muaj"!
Abdullahu (r.a) tha: "Unë kam mundësi të agjëroj më tepër".
Profeti (a.s) i tha: "Agjëro të hënën dhe të enjten"!
Abdullahu (r.a) tha: "Unë kam mundësi të agjëroj më tepër"
Profeti (a.s) i tha: "Agjëro një ditë po dhe një ditë jo! Kështu ka agjëruar Profeti i Allahut, Daudi (a.s)".
Abdullahu (r.a) tha: "Unë kam mundësi të agjëroj më tepër se kaq".
Profeti (a.s) tha: "Jo, nuk bën të agjërosh më shumë se kaq"!

Edukata ime gjatë agjërimit:

- Unë agjëroj në muajin e Ramazanit.
- Unë ngrihem në syfyr.
- Unë lexoj Kuran gjatë muajit të Ramazanit.
- Unë i lutem Allahut gjatë muajit të Ramazanit.
- Unë i fal teravitë në xhami, gjatë gjithë Ramazanit.
- Unë nuk gënjej gjatë Ramazanit.
- Unë nuk shaj dhe nuk ofendoj askënd, kur agjëroj. Kjo më nxit që të mos kryej asnjë veprim të pahijshëm edhe pas agjërimit



ARGËTIM DHE ZBAVITJE

A e dini se:

Kush e zbuloi algjebrën?

Atë e zbuloi dijetari musliman El-Khevarizmi.

Kuiz:

Janë tre fëmijë të shëndoshë nën një çadër dhe nuk lagen. Përse?

Përgjigja: Sepse nuk po bie shi.

Gjëegjëzë:

I zi dhe i bardhë
Zihen në një valë

(kafeja)

Për të qeshur:

Genti: Lale, në gjumë je
Lala: Jo.
Genti: Më jep 50 lekë, se dua të blej një akullore.
Lala: Ik ore, se po fle gjumë.

Ngjyros figurat:



Ushtrime

Ushtrimi 1: Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!

1- Cili është kushti i katërt i Islamit?
2- Çfarë do të thotë agjërim?
3- Cilat janë gjërat që e prishin agjërimin?
4- Kur fillon dhe mbaron koha e agjërimit?
5- A i është prishur agjërimi Aishes dhe përse?
6- Kur është zbritur Kurani?

Ushtrimi 2 : Plotëso vendet bosh!

1- "O ju të cilët keni besuar, ... ju është bërë detyrë...".
2- Muslimani agjëron vetëm për ..... të Allahut të Madhëruar.
3- Fatima, ne duhet të zgjohemi për të ngrënë ....., sepse bereqeti është tek ngrënia e.....
4- Gjatë agjërimit, muslimani duhet të largohet nga g....., sh..... dhe o.....
5- Kush ha gjatë agjërimit nga .....,, le ta dijë se Allahu e ka ushqyer.
6- Leximi i ..... është një vepër e mirë, që muslimani e bën gjatë Ramazanit.

Ushtrimi 3: Si kanë vepruar këta fëmijë? Vendos shenjën ✓ ose x për çdo rast.

- ☐ Andi shan dhe ofendon të tjerët, kur agjëron.
- ☐ Ajani lexon Kuran gjatë Ramazanit.
- ☐ Erda ha syfyr bashkë me familjen.
- ☐ Ledio i fal të gjitha teravitë në xhami.
- ☐ Jasmina i drejtohet Allahut me lutje, në natën e Kadrit.
- ☐ Kadriu piu ujë gjatë agjërimit, sepse kishte etje.
- ☐ Suada nuk ka dëshirë të agjërojë gjatë muajit të Ramazanit.

Ushtrimi 4: Mëso përmendësh!

1- Gjërat që e prishin agjërimin!
2- Duanë e iftarit!
3- Duanë që bëhet në 10-të ditëshin e fundit të Ramazanit!

Shtyllat e Islamit janë 5. Lidh siç duhet figurat e kolonës së majtë me figurat e kolonës së djathtë.

Mësimi 12

EDUKATA E DIJES

- Lexo!
- Studio!
- Mëso!
- Analizo!
- Thellohu në dituri!

Në shpellën Hira:

Kur Profeti Muhamed (a.s) ishte afër të dyzetave, filloi t'i pëlqente vetmia. Profeti Muhamed (a.s) merrte ushqim dhe ujë, pastaj shkonte në shpellën Hira.

Kohën e kalonte, duke mediuar rreth fakteve të krijimit në gjithësi.

Ishte muaji i Ramazanit, kur papritur i shfaqet engjëlli Xhebrail (a.s)

Engjëlli Xhebrail (a.s) e shtrëngoi Profetin (a.s) dhe pastaj i tha: "Lexo"!

Profeti Muhamed (a.s) tha: "Unë nuk di të lexoj".

Engjëlli Xhebrail (a.s) e shtrëngoi Profetin Muhamed (a.s) për së dyti dhe i tha: "Lexo"!

Profeti Muhamed (a.s) ia ktheu: "Unë nuk di të lexoj".

Engjëlli Xhebrail (a.s) e shtrëngoi për herë të tretë dhe i tha: "Lexo në emër të Zotit tënd, i Cili ka krijuar çdo gjë..."



Dija më e rëndësishme

Njëherë e një kohë, dijet u mblodhën diku dhe po diskutonin:

- Gjuha tha: "Unë jam dija më e rëndësishme, sepse u mësoj fëmijëve si të flasin".
- Matematika tha: "Unë jam më e rëndësishme, sepse u mësoj fëmijëve llogaritjet"
- Edukata tha: "Gjuha dhe matematika nuk i vlejnë njeriut, nëse ai nuk ka edukatë".



Feja po rrinte në një qoshe dhe po dëgjonte. . Gjuha, Matematika dhe Edukata e pyetën, se ç`mendim kishte ajo.

Si mendoni ju fëmijë: "Cila ishte përgjigja e fesë"?

Vlera e dijes:

- Nuk është i barabartë ai që di me atë që nuk di.
- Kush merr dije, Allahu ia lehtëson rrugën për në Xhenet.

- Krijesat e qiellit, të tokës madje edhe peshqit luten për atë, i cili mëson.
- Allahu e ngre në grada të larta njeriun e dijshëm.
- Dija është si shiu që zbret në një tokë, duke e bërë atë të japë prodhim me bollëk.
- Dija e shtyn njeriun, që të afrohet sa më shumë me Allahun.
- Nga dija përfitojnë të gjithë njerëzit.
- Dija është dritë.

Në orën e edukatës islame, fëmijët marrin njohuri rreth:

- Besimit tek Allahu
- Rregullave të fesë
- Adhurimeve
- Kuranit
- Profetit Muhamed (a.s)
- Moraleve islame

Shpërndarja e trashëgmisë së Profetit (a.s):

Njëherë, Ebu Hurejra (r.a) shkoi tek xhamia e Profetit Muhamed (a.s) Ebu Hurejra (r.a) e gjeti Profetin (a.s) duke dhënë mësim, por në xhami kishte shumë pak njerëz.

Menjëherë, Ebu Hurejra (r.a) shkoi në treg dhe u tha njerëzve: "O njerëz! Në xhaminë e Profetit (a.s) po shpërndahet trashëgimia e tij".

Njerëzit e lanë tregun dhe rendën me të katra për në xhami.

Kur hynë në xhami, panë Profetin (a.s) duke dhënë mësim. Të habitur i thanë Ebu Hurejras (r.a): "Përse na gënjeve? Profeti (a.s) nuk po shpërndan gjë"!

Ebu Hurejra (r.a) tha: "Dija që po jep Profeti (a.s), është trashëgimia më e madhe".

Bazat e dijes dhe dukatës



Familja

Shkolla

Xhamia

Rëndësia e shkollës:

- Shkolla është vendi, ku njeriu kalon pjesën më të bukur të jetës.
- Shkolla është vendi, ku njeriu mëson shkrim dhe këndim.
- Shkolla është vendi më i shtrenjtë, sepse aty gjen diturinë.
- Shkolla na mëson diturinë, moralin dhe sjelljen e mirë.
- Librat janë shokët më të mirë, më të dashur e më të besueshëm.
- Armët tona janë librat dhe lapsat, me të cilët përballim vështirësitë e jetës.

Jashari është një nxënës shembullor. Ai:

- përgatit mësimet për të nesërmen.
- i bën detyrat e shtëpisë.
- shkon në shkollë në orar.
- e dëgjon mësuesen në klasë.
- i bën detyrat e klasës pa gabime.
- merr vazhdimisht nota të larta në shkollë.

Edukata ime me dijen:

- Unë mësoj rreth besimit dhe fesë.
- Unë shkoj në xhami për të mësuar.
- Unë gjithmonë i bëj detyrat e shtëpisë dhe të klasës.
- Unë gjithmonë i përgatis mësimet për ditën e nesërme.
- Unë i dëgjoj mësuesit dhe mësueset me vëmendje.
- Unë marr nota të larta në shkollë.
- Unë lexoj edhe libra jashtëshkollorë.

ARGËTIM DHE ZBAVITJE

A E DINI SE:

Kush e zbuloi kiminë?

Atë e zbuloi Jabin ibn Hajjan, i cili kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij në Irak, duke u marrë me zbulimin e kimisë.

Kuiz:

Çfarë ka deti në fund?

Përgjigja: Shkronjën "i"

Gjëegjëzë:

Sa të duash
Ka plot deti
Nevojë për të
Ka edhe mbreti

(kripa)

Për të qeshur:

Genti: O babi, mora një 10-të sot.
Babai: Sa mirë, paske filluar të mësosh
Genti: Jo o babi jo, por mora një 5-së në gjuhë dhe një 5-së në matematikë.

Gjej 15 objektet e fshehura

Ushtrime

Ushtrimi 1: Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!

1- Cili është ajeti i parë, që i është shpallur Profetit Muhamed (a.s)?
2- Thuaj përse dija ka vlerë?
3- Kush ishte trashëgimia, që po shpërndahej në xhaminë e Profetit (a.s)?
4- Ku i merr njeriu bazat e dijes?
5- Përse shkolla është e rëndësishme?
6- Çfarë notash merr Jashari në shkollë?

Ushtrimi 2 : Plotëso vendet bosh!

1- ..... me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi çdo gjë!
2- Dija është .....
3- Në xhaminë e Profetit (a.s) po shpërndahet ..... e tij.
4- Shkolla është vendi, ku njeriu mëson ..... dhe .....
5- Armët tona janë ..... dhe lapsat.
6- Jashari e ..... mësuesen në klasë.

Ushtrimi 3: Si kanë vepruar këta fëmijë? Vendos shenjën ✓ ose x për çdo rast.

- ☐ Ana zhgarravit librat e shkollës.
- ☐ Selma po përgatit mësimet për nesër.
- ☐ Amiri shkon në xhami për të mësuar për fenë.
- ☐ Iljazi dëgjon me vëmendje mësuesin.
- ☐ Sibora ha fara në klasë.
- ☐ Jasemina bën zhurmë në orën e mësimit.
- ☐ Sokoli mungon në shkollë pa arsye.

Ushtrimi 4: Mëso përmendësh!

1- Rreth vlerës së dijes!
2- Bazat e dijes!
3- Rëndësinë e shkollës!

Diskutoni me babin dhe mamin për historikun e Xhamisë Aya Sofia në Stamboll.



Mësimi 13

EDUKATA KUNDRA SHEJTANIT

Allahu thotë në Kuran:

"Me të vërtetë, shejtani është armik për ju, prandaj shikojeni si armik. Ai i nxit ithtarët e tij, që të bëhen shokë të zjarrit të përflakur".

"O besimtarë! Mos ndiqni gjurmët e shejtanit. Kush ndjek gjurmët e shejtanit, do të nxitet nga ai, të bëjë vepra të këqija dhe të shëmtuara".

- Shejtani është armiku më i madh i njeriut.
- Shejtani e shmang njeriun nga besimi.
- Shejtani e shmang njeriun nga rruga e drejtë.
- Shejtani e nxit njeriun për të bërë punë të këqija.
- Shejtani dëshiron, që njeriu të jetë në Xhehenem.
- Shejtani është mendjemadhi më i madh.
- Shejtani është gënjeshtari më i madh.
- Shejtani i frikëson njerëzit me varfëri dhe u jep shpresa të kota.

Kur Allahu e krijoi Ademin (a.s), u tha engjëjve: "Bini në sexhde"!
Bashkë me engjëjt ishte edhe Iblisi (shejtani)
Të gjithë engjëjt ranë në sexhde, përveç Iblisit.
Allahu e pyeti Iblisin: "Përse nuk re në sexhde"?
Iblisi tha: "Unë jam më i mirë se ai (njeriu). Mua më krijove nga zjarri, kurse atë e krijove nga dheu".
Allahu e përzuri Iblisin nga Mëshira e Tij.
Pastaj, Allahu krijoi Havanë, gruan e Ademit (a.s)
Ademi (a.s) dhe Havaja jetonin në Xhenet.
Allahu i tha Ademit (a.s) dhe Havasë: "Hani nga të gjitha pemët, përveç njërës".
Mirëpo, shejtani e mashtroi Ademin (a.s) dhe Havanë, kështu që ata të dy hëngrën nga pema.
Kur Allahu e zbriti Ademin (a.s) dhe Havanë në Tokë, u tha: "Kini kujdes nga shejtani, sepse ai është armiku juaj".

Një ditë Profeti (a.s) bëri një vizë të drejtë në tokë dhe pastaj bëri disa viza të tjera anash saj.
Më pas tha: "Kjo (viza e drejtë) është rruga e drejtë, kurse në krye të çdo rruge tjetër ka nga një shejtan. Prandaj ju ndiqni rrugën e drejtë dhe mos ndiqni rrugët e tjera"!

Shejtani kërkon ta largojë njeriun nga rruga e drejtë. Për këtë arsye ai:

- Përpiqet ta largojë njeriun nga besimi
- Përpiqet ta largojë njeriun nga adhurimi
- Përpiqet ta largojë njeriun nga kryerja e veprave të mira vullnetare
- Përpiqet ta shtyjë njeriun, që të bëjë mëkate
- Përpiqet t`ia humbë kohën e lirë njeriut, duke e angazhuar me gjëra të kota

Istiadhja

Eudhu bil-lahi minesh-shejtani rraxhim

Kërkoj mbrojtjen e Allahut kundër shejtanit të mallkuar

Në orën e edukatës islame, fëmijët mësojnë se kur duhet thënë "Istiadhja":

- Kur njeriu është i nxehur dhe i inatosur
- Kur leh qeni dhe kur pëllet gomari
- Përpara se të lexosh Kuran
- Përpara se të hysh në tualet
- Kur fillon dhikrin e mëngjesit dhe të mbrëmjes
- Kur zgjohesh i frikësuar nga gjumi
- Gjatë faljes së namazit

Profeti (a.s) e porositi Ebu Hurejren (r.a), që të ruante pasurinë e mbledhur nga sadakaja. Gjatë natës, dikush u afrua dhe filloi të merrte nga kjo pasuri, por Ebu Hurejra (r.a) nuk e lejoi. Njeriu tha se ishte nevojtar, prandaj Ebu Hurejra (r.a) e la të lirë. Në mëngjes, Ebu Hurejra (r.a) ia tregoi këtë gjë Profetit (a.s), i cili tha: "Të ka gënjyer".

E njëjta gjë ndodhi edhe natën tjetër. Të nesërmen, Profeti (a.s) i tha Ebu Hurejras (r.a): "Të ka gënjyer".

Në natën e tretë, Ebu Hurejra (r.a) vendosi të mos e lejonte më personin, që të merrte nga pasuria e sadakasë, por ai i tha: "Më lër, se do të të tregoj, se si të ruhesh nga shejtani: "Kur të shtrihesh për të fjetur, lexo ajetin Kursij dhe Allahu do të caktojë një roje (engjëll), që do të të mbrojë prej tij deri në agim".

Të nesërmen në mëngjes, Ebu Hurejra (r.a) ia tregoi këtë gjë Profetit (a.s), i cili tha: "Ai ishte shejtani i mallkuar dhe të ka thënë të vërtetën, megjithëse ai vetë është gënjeshtar".

Ajeti Kursij

Allahu la ilahe il la hu uel haj jul kaj jum
La te'khudhuhu sinetun ue la neum
Lehu ma fis semauati ue ma fil erdi
Men dhel ledhi jeshfeu indehu il la bi idhnihi
Ja'lemu ma bejne ejdihim ue ma khalfehum
Ue la juhitune bi shej'in min ilmihi il la bima sha
Uesia kursijuhus semauati uel erdi, ue la
jeuduhu hifdhuhuma ue huuel alij jul adhim

Përkthimi:

Allahu! Nuk ka zot tjetër përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje!
Atë nuk e kaplon as dremitja as gjumi.
Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej e në Tokë.
Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd, pa lejen e Tij?
Ai di gjithçka që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve,
kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron.
Kursija e Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t'i ruajë ato
Ai është i Larti, Madhështori.

Edukata ime kundra shejtanit:

- Unë e konsideroj shejtanin armik.
- Unë nuk i ndjek hapat e shejtanit.
- Unë adhuroj vetëm Allahun.
- Unë i bindem dhe i respektoj urdhrat e Allahut.
- Unë ndjek rrugën e drejtë.
- Unë nuk ndjek rrugët e shtrembra.
- Unë përpiqem të mos bëj asnjë mëkat.

ARGËTIM DHE ZBAVITJE

A E DINI SE:

Kush e dha idenë e mjeteve kirurgjikale?

Ai ishte El-Zahravi, i lindur më 936 në Kordoba, Spanjë. Ai ishte fizikant revolucionar dhe kirurg. Ai ka shkruar një ndër enciklopeditë mjekësore me më shumë influencë.



Kuiz:

Cila është ajo fjalë shqipe, që ndryshe shkruhet dhe ndryshe lexohet?

Përgjigja: Vetë fjala "Ndryshe".

Gjëegjëzë:

Ç'është një kuti
Me ngjyra e zë
Ku ne gjithçka shohim
Brenda në të

(televizori)

Për të qeshur:

Genti dhe Beni kishin secili nga një qen.

Genti: Beni, a ia këput veshin qenit tënd, që t'i dallojmë?

Beni: Po

Mirëpo një ditë qentë zihen dhe qeni i Benit ia këput veshin qenit të Gentit.

Genti: Beni, a ia këput bishtin qenit tënd, që t'i dallojmë?

Beni: Po.

Mirëpo një ditë qentë zihen përsëri dhe qeni i Benit ia këput bishtin qenit të Gentit.

Beni: Po tani, çfarë të bëjmë që t`i dallojmë qentë nga njëri-tjetri?

Genti: Po ja ky qeni i bardhë është i imi, kurse qeni i zi është i yti.

I gjeni dot objektet e qarkuara?



Ushtrime

Ushtrimi 1: Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!

1- Kush është armiku më i madh i njeriut?
2- Përse Iblisi nuk ra në sexhde?
3- Nga çfarë kërkon shejtani ta largojë njeriun?
4- Kur duhet ta thotë njeriu "Istiadhen?
5- Përse nuk duhet të ndjekim gjurmët e shejtanit?
6- Përse muslimani duhet ta lexojë ajetin kursij, kur të shtrihet për të fjetur?

Ushtrimi 2 : Plotëso vendet bosh!

1- O besimtarë! Mos i ndiqni gjurmët e .....
2- Shejtani e nxit njeriun të bëjë punë të .....
3- Mirëpo shejtani e ..... Ademin (a.s) dhe Havanë dhe ata të dy hëngrën nga pema.
4- Prandaj ju ndiqni rrugën e ..... dhe mos ndiqni rrugët e tjera.
5- Shejtani kërkon ta largojë njeriun nga b.....
6- Kur të shtrihesh për të fjetur, lexo ajetin .....

Ushtrimi 3: Si kanë vepruar këta fëmijë? Vendos shenjën ✓ ose x për çdo rast.

☐ Sajmiri nuk dëshiron të falë namazin.

☐ Armejda thotë ajetin kursij, para se të flejë gjumë.

☐ Marsida nxehet shumë shpejt për hiç gjë.

☐ Ani dëgjon me vëmendje mësuesin, i cili flet për armiqësinë, që njeriu duhet të ketë ndaj shejtanit.

☐ Berti thotë "Istiadhen", përpara se të fillojë të lexojë Kuranin.

☐ Kerimi zihet me shokët.

☐ Eltoni është shumë mendjemadh.

Ushtrimi 4: Mëso përmendësh!

1- Ngjarjen e Iblisit me Ademin (a.s)!
2- Istiadhen!
3- Ajetin Kursij!

Mësimi 14

EDUKATA ME PRINDËRIT

Prindërit
Dhurata e Zotit

Nëna dhuron gjithmonë dashuri

Xheneti është nën këmbët e nënës

Një njeri e pyeti Profetin Muhamed (a.s):
"Cila është puna më e mirë tek Allahu"?
Profeti (a.s) tha: "Sjellja e mirë me prindërit".

Dialog:

Lina: Mami, më jep një gotë ujë.
Mami: Nuk të dëgjova.
Lina: Më jep një gotë ujë.
Mami: Përsëri nuk të dëgjova
Lina: Hëm.. (mendohet pak). Mami të lutem më jep një gotë ujë.
Mami: Tani të dëgjova. Urdhëro!
Lina: Faleminderit mami.

Ajani është një djalë i edukuar

Nga goja e tij dëgjojmë vetëm këto fjalë:
- Si urdhëron babi
- Të lutem
- Faleminderit
- Më fal mami...

Ajani ia puth gjithmonë dorën prindërve.

Dialog:

Babai: Sami, të lutem më jep pak Kuranin!
Samiu: Si urdhëron babi.
Mami: Aishe, të lutem fshiji pluhurat e shtëpisë!
Aishja: Si urdhëron mami.
Babai: Luti, të lutem shko bli një bukë tek dyqani!
Luti: Si urdhëron babi.

Si duhet të sillemi me prindërit:

- Mos e ngri zërin përpara prindërve!
- Gjithmonë dëgjoji fjalët e prindërve!
- Ndihmoji prindërit në punët e shtëpisë!
- Mos i ndërprit prindërit, kur ata flasin!
- Kurrë mos u sill keq me prindërit!
- Kurrë mos mbaj inat me prindërit!
- Respektoje gjithmonë fjalën e prindërve!
- Asnjëherë mos dil nga shtëpia pa lejen e prindërve!

"Kur ndonjëri prej tyre, apo që të dy të plaken, mos u thuaj as: "Ufff"



- Mos i kundërshto prindërit!
- Respektoji!
- Lutu për ta!
- Thuaju fjalë të mira!

Edukata ime me prindërit:

- Unë i dua prindërit e mi.
- Unë i respektoj prindërit e mi.
- Unë i bindem fjalëve të prindërve të mi.
- Unë i përqafoj gjithmonë prindërit e mi.
- Unë i ndihmoj prindërit e mi.
- Unë mundohem të kënaq prindërit e mi.
- Unë lutem për prindërit e mi.

ARGËTIM DHE ZBAVITJE

A E DINI SE:

Kush e krijoi kamerën e parë?

Ai ishte Ibn El-Hejthem, i lindur më 965 në Basra, Irak. Ai ka shkruar librin për optikën, në të cilin hodhi themelet e kësaj shkence.

Kuiz:

Rustemi ka 4 motra. Dy motra u martuan. Sa motra i ngelën Rustemit?

Përgjigja: 4 motra dhe jo 2.

Gjëegjëzë:

Dy motra pranë e pranë
Shohin gjithë dynjanë
Por me njëra - tjetrën nuk shihen

(syrë)

Për të qeshur:

Beni: Ai lart atje në qiell është dielli.
Luli: Jo, ajo është hëna.
Secili prej tyre këmbëngulte në të veten.
Beni: Hajde të pyesim Gentin!
Luli: Genti! Ai atje është dielli apo hëna.
Genti: Nuk e di, sepse ai nuk jeton në lagjen time.

Sa rrathë ka tek kjo skemë?



Ushtrime

Ushtrimi 1: Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!

1- Kush është dhurata e Zotit?
2- Kush është ajo, që na dhuron më shumë dashuri?
3- Përse nënën nuk e zë gjumi?
4- Cila është puna më e mirë pas adhurimit të Zotit?
5- Cilët janë fjalët e Ajanit karshi prindërve?

Ushtrimi 2 : Plotëso vendet bosh!

1- ..... janë dhurata e Zotit.
2- Xheneti është nën ..... e nënave.
3- Mami,..... më jep një gotë ujë.
4- Më..... mami.
5- Si..... babi.
6- Mos u thuaj as "....."."

Ushtrimi 3: Si kanë vepruar këta fëmijë? Vendos shenjën ✓ ose x për çdo rast.

☐ Jusra i bërtet mamit.
☐ Omeri i bindet prindërve.
☐ Megi dëshiron të fitojë kënaqësinë e prindërve.
☐ Bilbili i jep urdhra prindërve.
☐ Joni bën shaka me prindërit.
☐ Selimi kërkon me mirësjellje nga prindërit, që ta lejojnë të luajë jashtë me top.
☐ Taulanti nga inati nuk iu flet prindërve me gojë.

Ushtrimi 4: Mëso përmendësh!

1- Xheneti është nën këmbët e nënës!
2- Fjalët "magjike" të mirësjelljes me prindërit!
3- Këshillat se si duhet të sillesh me prindërit!

Mësimi 15

EDUKATA ME KOHËN

Allahu thotë në Kuran:

"Betohem në kohën!
Me të vërtetë njeriu është në humbje të sigurtë
Përveç atyre:
1- Që besojnë
2- Që bëjnë punë të mira
3- Këshillojnë njëri - tjetrin për të vërtetën dhe
4- Këshillojnë njëri - tjetrin për të bërë durim".

Njerëzit tregohen neglizhentë në dy mirësi. Ato janë:



1- Shëndeti
2- Koha e lirë

Fazat e jetës së njeriut





Koha është si thika
Nëse nuk e përdor me kujdes,
do të presësh dorën.

Hoxha dhe koha e njerëzve:

Shumë kohë më parë jetonte një hoxhë i nderuar. Ai quhej Xhemaludin Kasimi.

Hoxhë Xhemaludini ishte njeri studioz dhe nuk e harxhonte kohën asnjëherë kot. Një ditë, teksa po shkonte në xhami bashkë me një mikun e tij, pa një numër të madh njerëzish, që po rrinin në kafene, duke pirë kafe, çaj e gjëra të tjera.

Fytyra e hoxhës ndryshoi dhe u mërzit nga ajo që pa. Miku i tij e vuri re ndryshimin e fytyrës së hoxhës, prandaj e pyeti: "Ç'pate"?

Hoxha tha: "Miku im! A nuk e shikon, se si e harxhojnë kohën kot gjithë këta njerëz?! Ah sikur ta blija kohën e të gjithë këtyre njerëzve dhe ta shfrytëzoja vetëm për të mësuar e për të bërë punë të dobishme".

Rauda mësoi, se duhet ta shfrytëzonte kohën vetëm për punë të dobishme, si p.sh:

- Për të mësuar mësimet e shkollës.
- Për të ndihmuar në punët e shtëpisë.
- Për të ndihmuar nevojtarët.
- Për të lexuar Kuran.
- Për të bërë dhikër.
- Për të falur namazin.
- Për të luajtur, por me orar.



Jasmina është një vajzë shembullore

Ajo e shfrytëzon kohën ditore vetëm për punë të mira.
Në mëngjes, ajo çohet për të falur namazin e Sabahut
Pas namazit bën dhikrin dhe lutet.
Pastaj ha mëngjesin dhe përgatitet për të shkuar në shkollë
Kur vjen nga shkolla, fal namazin e drekës.
Pastaj ha bukë dhe pushon.
Pas pushimit, fal namazin e Ikindisë.
Më pas ajo bën mësimet e shkollës.
Pasi fal namazin e Akshamit, bën dhikrin dhe lexon Kuran.
Pas namazit të Jacisë imbetet edhe pak kohë, që të lexojë ndonjë faqe nga libri jashtëshkollor.
Përpara se të flejë gjumë, ajo nuk harron që të lexojë lutjet e gjumit.

Dialog:

Huejda: Mami, të dal të luaj pak?
Mami: Po, por jo më tepër se gjysëm ore.
Huejda: Mirë mami
Pas gjysëm ore...
Mami: Huejda, hajde në shtëpi se kaloi gjysëm ore.
Huejda: Oh..mami, por unë dua të luaj edhe pak
Mami: As edhe një minutë më tepër. Gjella me kripë dhe kripa me karar.
Huejda: Çfarë do të thotë kjo mami, se nuk e kuptoj
Mami: Po ja. Kripa është e nevojshme për gjellën, por nëse gjellës i hedh më shumë kripë, ajo nuk hahet më.
Huejda: Po ç`lidhje ka kjo me mua?
Mami: Po ja, loja është e nevojshme për ty si fëmijë, por ti nuk duhet të luash më tepër seç duhet.
Huejda: Mirë mami.

Hajdutët e kohës

Muslim Kids TV është një faqe interneti dhe platformë Islame shumë e dobishme për fëmijët

Të dielën, Albi doli për një shëtitje në park bashkë me familjen e tij. Ata kishin marrë edhe topin me vete.

Albi luajti edhe me disa fëmijë të tjerë, që kishin ardhur aty, bëri gara vrapimi me babin dhe bleu një akullore.

Ajri i freskët ia mbushi mushkëritë dhe ia gjallëroi trupin.

Ai u kërkoi prindërve, që të dilnin çdo të diel për shëtitje në park dhe ata pranuan. Albi u kënaq pa masë.

Dialog:

Mësuesja: Mirë se keni ardhur fëmijë në këtë vit të ri shkollor.
Nxënësit: Mirë se të gjetëm mësuese.
Mësuesja: Abdullah, ku i ke kaluar pushimet verore?
Abdullahu: Kam shkuar në një qendër islame, për të mësuar rreth fesë.
Mësuesja: Po ti Fatime, ku i ke kaluar pushimet verore?
Fatimja: Kam lexuar disa libra.
Mësuesja: Po ti Arben, ku i ke kaluar pushimet verore?
Arbeni: Kam qenë në plazh bashkë me familjen.
Mësuesja: Po ti Suada, ku i ke kaluar pushimet verore?
Suada: Bashkë me familjen në mal.
Mësuesja: Po ti Shkëlzen, ku i ke kaluar pushimet verore?
Shkëlzeni: Jam marrë me aktivitete sportive.
Mësuesja: Shumë mirë fëmijë. Vërtet, paskeni kaluar pushime mjaft të këndshme.

Edukata ime me kohën:

- Unë e kaloj kohën vetëm duke bërë punë të mira.
- Unë falem pesë herë në ditë.
- Unë lexoj Kuran çdo ditë.
- Unë bëj dhikër çdo ditë.
- Unë i bëj detyrat dhe mësimet.
- Unë lexoj libra jashtëshkollorë.
- Unë luaj dhe argëtohem, por me orar.
- Unë dal shëtitje me prindërit një herë në javë.

ARGËTIM DHE ZBAVITJE

A E DINI SE:

Kush i zbuloi digat?

Dizejnimi dhe estetika e shumë digave është përpiluar në shekullin e 9-të nga Aghlabidet e Tunizisë.

Kuiz:

Cili është ai numër, që nëse e kthen mbrapsht bëhet më i madh se vetja?

Përgjigja: Ai është numri 6, sepse kur e kthen mbrapsht ai bëhet 9.

Gjëegjëzë:

Katër motra shkojnë e vijnë (rrotat e makinës)
Njëra - tjetrën se arrijnë

Për të qeshur:

Doktori: Merre këtë ilaç dhe pi 5-së lugë në ditë.
Genti: Doktor, po unë kam vetëm 4 lugë në shtëpi.

Gjej fjalët e mëposhtme!

Agjërimi, Syfyri, Iftari, Prindër, Shejtan, Koha, Dija.

A	Z	E	T	O	X	C	V	B	I
Sh	E	J	T	A	N	P	L	U	F
B	R	I	A	V	Y	R	K	D	T
U	K	A	Gj	Ë	R	I	M	I	A
T	O	C	K	Y	H	N	N	J	R
E	H	Zh	Xh	S	Th	D	Z	A	I
Y	A	E	Rr	I	D	Ë	F	Nj	Q
I	L	S	Y	F	Y	R	I	G	P

Ushtrime

Ushtrimi 1: Përgjigju pyetjeve të mëposhtme!

1- Cilat janë dy mirësitë, për të cilat njerëzit tregohen neglizhentë?
2- Cilat janë fazat e njeriut?
3- Si shfrytëzohet koha me punë të dobishme?
4- Përse ndryshoi fytyra e hoxhës?
5- Çfarë bën Jasmina gjatë ditës?
6- Cilët janë hajdutët e kohës?

Ushtrimi 2: Plotëso vendet bosh!

1- Betohem në .....
2- Koha është si ....., nëse nuk e përdor me kujdes, do të ..... dorën.
3- Ah, sikur ta .....kohën e të gjithë këtyre njerëzve dhe ta shfrytëzoja vetëm për të ..... dhe për të bërë punë të .....
4- Loja është e .....për ty si fëmijë, por jo më t..... se çduhet.
5- Suada i ka kaluar pushimet me familjen në .....
6- I..... dhe c.....janë hajdutët e kohës.

Ushtrimi 3: Si kanë vepruar këta fëmijë? Vendos shenjën ✓ ose x për çdo rast.

- ☐ Arseni luan gjithë ditën me top.
- ☐ Selma po bën detyrat e shtëpisë.
- ☐ Rukija po lexon Kuran.
- ☐ Selimi shkon në mal për alpinizëm.
- ☐ Sherifja rri gjithë ditën në istagram.
- ☐ Rejani nuk lë asnjë film pa parë.
- ☐ Tesnima po lexon një libër.
- ☐ Amari luan pa pushim në celular.

Ushtrimi 4: Mëso përmendësh!

1 – Çfarë thotë Allahu në Kuran në lidhje me kohën!
2 – Dy mirësitë që njerëzit i neglizhojnë!
3 – Kush janë hajdutët e kohës!

Cili po e shfrytëzon kohën siç duhet? Vendos shenjën ✓ ose x për çdo rast.

☐ ☐